



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DURRËS

**ANALIZA VJETORE E PUNËS SË PROKURORISË PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DURRËS**

VITI 2019

HJRJE

Në zbatim të detyrimeve që përcakton ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, paraqes përpara Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, analizën vjetore të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me juridiksion të përgjithshëm për vitin 2019.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës gjatë vitit 2019 ka patur në organikën e saj një numër prej 26 prokurorësh, ku përfshihen një Drejtues, një Zëvendës Drejtues dhe njëzet e katër prokurorë sektori. Po kështu dhe 15 oficerë të policisë gjyqësore. Për vitin 2019 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka operuar me 22 prokurorë, pasi prokurorët Ardian Ylli, Donika Prela, Agron Gjana dhe pjesërisht Elena Pelushi kanë ushtruar detyrën e tyre të caktuar pranë Prokurorisë të Shkallës së Parë Vlorë, Prokuroria për Krime të Rënda, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Prokuroria e Përgjithshme. Gjithashtu deri në muajin tetor 2019 kanë ushtruar detyrën përkohësisht tre prokurorë të ardhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, Fier dhe Tiranë.

Nëpërmjet këtij materiali do të paraqesim treguesit e punës së veprimtarisë së përgjithshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, realizuar gjatë vitit 2019, në ushtrimin e ndjekjes penale, në hetimin paraprak dhe në gjykim si dhe përbushjen e detyrimeve të tjera ligjore nga Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore.

Po kështu do të paraqesim në mënyrë të përmbledhur treguesit e punës, ecurinë, progresin, por dhe mangësitë e konstatuara në punën tonë, zgjidhjet ligjore të dhëna dhe hapat e hedhura për zhvillimin dhe përmirësimin e standarteve në punë, performancën e Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Nëpërmjet analizës vjetore të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, do të ndalemi në mënyrë të përgjithshme, të përmbledhur, por dhe të detajuar në aspekte të veçanta të gjithë treguesve lidhur me veprimtarinë e punës për periudhën njëvjeçare. Informacioni përmban të dhëna mbi numrin e çështjeve dhe materialeve kallëzuese të regjistruara, mënyrën e zgjidhjes ligjore të tyre, numrin e çështjeve të mbartura nga viti i kaluar, por dhe ecurinë e çështjeve të dërguara gjykatës, etj.

Në një vlerësim paraprak, nisur nga të dhënat që do të analizojmë në mënyrë të detajuar, elementi i parë që evidentohet dukshëm është se gjatë vitit 2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka përballuar ngarkesën më të lartë të punës, krahasuar me vitet e mëparshme. Kështu në raport me vitin 2018 gjatë vitit 2019 janë trajtuar në total **5887** materiale hetimore, nga **5195** materiale hetimore të trajtuara në vitin 2018, me një rritje në masën **13.32%**.

Gjatë trajtimit të këtyre materialeve është konkluduar dhe më pas është vendosur regjistrimi i procedimeve penale për **2823** procedime, në krahasim me vitin 2018 ku janë regjistruar **2779** procedime. Konstatohet se kemi rritje në masën 1.58% të regjistrimeve për procedimet penale krahasuar me vitin 2018.

Në vitin 2019 është vendosur mosfillimi për **1907** materiale kallëzuese, ndërsa për vitin 2018 janë mosfilluar **1455** materiale kallëzuese. Krahasuar me vitin 2018 rezulton se kemi një rritje prej 31.06% të materialeve hetimore për të cilat prokurorët kanë vendosur mosfillimin e procedimeve penale.

Evidentohet progres krahasuar me vitet paraardhëse si dhe arritje në efektivitetin e ndjekjes penale kundër krimit, për të cilat Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është kompetente për hetimin dhe ndjekjen e tyre. Pavarësisht nga të dhënat që do të prezantohen, jemi të vetëdijshëm se duhet të merren masa të tjera të domosdoshme për të garantuar rritjen

e suksesit në luftën kundër krimit, duke kërkuar mbështetje dhe në strukturat e tjera ligjzbatuese të shtetit.

Gjatë vitit 2019, vlen për t'u theksuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka përballuar një situatë të jashtëzakonshme siç është është ajo e ndodhur për shkak të tërmetit të 26 nëntorit. Tërmeti e kishte epiqendrën në rrethin e Durrësit dhe pasojat që ai solli në këtë qytet dhe rrethinat e tij kanë qenë shumë të rënda, dhe me pasoja fatale pasi ka shkaktuar dhjetra viktima. Por në kohën kur të gjithë largoheshin nga Durrësi, për shkak të tërmetit, prokuroria ka qenë në krye të detyrës duke bërë të mundur evidentimin, kqyrjen dhe marrjen e materialeve për ekspertim jo vetëm në objektet me viktima, por edhe në të gjitha objektet të cilat janë të dëmtuara rëndë nga tërmeti shkatërrimtar. Ndaj gjej rastin t'i falendëroj kolegët e mi prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore dhe gjithë stafin e kësaj prokurorie. Në këtë hetim ne nuk kemi qenë vetëm, por kemi patur mbështetjen e Prokurorit të Përgjithshëm i cili ka ardhur dhe na ka mbështetur publikisht. Po jo vetëm kaq, nëpërmjet misionit të Pameca 5, Prokurori i Përgjithshëm ka bërë të mundur që në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës të mbërrijnë kolegë prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore dhe ekspertë të lartë nga Prokuroria e Aquila-s, të cilët na kanë sjellë eksperiencën e tyre ne hetimin e këtyre çështjeve.

Menjëherë pas rënies së tërmetit dhe përfundimit të punës nga ekipet e shpëtimit është regjistruar kryesisht procedimi penal 2466 dhe në një kohë rekord është bërë e mundur që për rastet me viktima të evidentohen dhe të nxirren 17 urdhra ndalimi për persona të dyshuar për vepra penale siç janë ato të parashikuara nga neni 199/a, 248, 186, 79/dh dhe 76 të Kodit Penal. Gjatë kësaj periudhe rezulton të jenë regjistruar 244 procedime penale vetëm për çështjet e tërmetit dhe prokurorët e Seksionit Ekonomik që hetojnë këto vepra penale vazhdojnë të jenë të angazhuar maksimalisht me qëllim evidentimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të personave përgjegjës në rastet e objekteve me dëmtime të rënda.

Mënyra më sintetike e përshkrimit të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës në ushtrimin e funksioneve të saj është parashtrimi i të dhënave nëpërmjet shifrave, prandaj më lejoni t'ju paraqes të grupuara treguesit e punës për periudhën njëvjeçare, shtrirjen dhe tendencat e kriminalitetit.

PËRMBAJTJA

Hyrje	2
I. Drejtimet dhe Përparësitë në Luftën kundër Kriminalitetit për Vitin 2019	5
1. Lufta kundër Korrupsionit dhe Krimin Ekonomik	5
2. Lufta kundër Lëndëve Narkotike	11
3. Respektimi i të Drejtave të Njeriut	11
4. Të Miturit dhe Grupet Vulnerabël, si të Pandehur dhe Viktimat.....	11
5. Bashkëpunimi Ndërinstitucional.....	14
6. Bashkëpunimi Ndërkombëtar	15
7. Përdorimi i Metodave Speciale Hetimore dhe Hetimet Proaktive.....	16
8. Informacion mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të Nxjerra në Bazë të Tyre	18
9. Informacion Statistikor mbi Çështjet Penale që Lidhen me Procesin e Verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrjnë Funksione Publike	18
10. Prioritetet e Prokurorisë gjatë Vitit 2019	18
11. Problematikat e Hasura	19
II. Analiza e Treguesve të Kriminalitetit dhe Punës së Prokurorisë	21
1. Volumi i Punës në Hetim.....	21
2. Çështje të Përfaqësuara në Gjykatë.....	22
3. Treguesit Kryesor të Punës së Prokurorisë	23
4. Të Dhëna në Lidhje me Njoftimet për Veprat Penale.....	26
5. Të Dhënat në Lidhje me Masat e Sigurimit Personal e Pasuror	26
6. Treguesit e Ekzekutimeve të Vendimeve Gjyqësore të Formës së Prerë	26
7. Kriminaliteti sipas Peshës/Përhapjes së Veprave Penale dhe Tendencat e Tyre	29
8. Kriminaliteti sipas Strukturës së Kodit Penal	31
III. Treguesit Statistikorë 2-Vjeçar të Veprave Penale sipas Strukturës së Kodit Penal	34
IV. Analiza e Treguesve të Efektivitetit të Punës së Prokurorisë	58
1. Treguesit e Efektivitetit në Gjykim dhe në Dënimin e të Pandehurve	58
2. Të Dhëna për Gjykimet e Posaçme.....	59
3. Të Dhënat mbi Llojet dhe Masat e Dënimeve	62
4. Të Dhëna Sociale dhe Demografike për të Pandehurit	65
5. Të Dhënat për Pasojat e Veprave Penale	67
V. Të Dhënat Lidhur me Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja.....	68
VI. Të Dhënat për Ngarkesën e Punës për çdo Prokuror dhe Oficer të Policisë Gjyqësore	70
VII. Informacion mbi Administrimin e Prokurorisë	73
VIII. Drejtimet dhe Përparësitë në Luftën Kundër Kriminalitetit për Vitin Pasardhës dhe Rekomandime.....	75

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2019

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës gjatë vitit 2019 është fokusuar në ushtrimin e ndjekjes penale dhe perfaqësimin e akuzës në gjykatë duke patur në fokus të saj ndëshkimin e veprave penale të korrupsionit, kundër lëndëve narkotikëve, krimit dhe fenomeneve të tjera në shkelje të ligjit. Qëllimi i punës së të gjithë prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës ka qenë rritja e standarteve të hetimit të procedimeve penale si dhe mbrojtja e akuzës në gjykatë duke kërkuar forcimin e profesionalizmit dhe integritetit të prokurorëve. Drejtimi dhe përparësitë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës në luftën kundër kriminalitetit kanë qenë të fokusuar kryesisht:

1. LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT EKONOMIK

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës ka patur si prioritet të saj gjatë vitit 2019 hetimin e veprave penale të korrupsionit që lidhen me atë kategori veprash për të cilat kjo prokurori është kompetente për ushtrimin e ndjekjes penale. Veprat penale kundër korrupsionit janë hetuar nga Seksioni për Hetimin e Krimit Ekonomik, Financiar dhe Kibernetik i krijuar pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës Parë Durrës.

Gjatë vitit 2019 prokurorët e këtij seksioni kanë hetuar një sërë veprash penale, ku objekt i tyre ka qenë korrupsioni. Nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2019, nga ky seksion, janë hetuar për nenin 244, të K.Penal, **9** çështje, për nenin 245/a/1-2 të K. Penal, **4** çështje, neni 164/a të K.Penal, **1** procedim penal, neni 259 i K.Penal, **10** procedime penale, neni 287 K.Penal, **64** procedime penale, neni 143/b K.Penal, **9** procedime penale, neni 258 K. Penal, **4** procedime penale, për nenin 248 K. Penal, **258** procedime penale.

Rol kryesor në hetimin e këtyre veprave penale ka patur Seksioni për Hetimin e Krimit Ekonomik, Financiar dhe Kibernetik i cili gjatë vitit 2019 në bashkëpunim me strukturat e specializuara në ushtrimin e ndjekjes penale, në fushën e korrupsionit, krimit ekonomik, pastrimit të parave dhe krimit kibernetik ka kryer veprimtarinë e tij. Ky seksion për vitin 2019 është përpjekur për të qenë eficient për hetimin e krimit të korrupsionit, krimit ekonomik, pastrimit të parave etj. Megjithëkëtë mbetet akoma shumë për të bërë.

Vlen për t'u theksuar fakti se për veprën penale të "Pastrimit të Produkteve të Veprës Penale" parashikuar nga neni 287 i K.Penal, nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2019 janë regjistruar **15** procedime penale krahasuar me një vit më parë kemi rritje përsa i përket veprave penale të kësaj kategorie. Gjatë vitit 2019 vlen për t'u përmendur se dy procedime me një të pandehur është dërguar për gjykim dhe kemi një të pandehur të dënuar për njerin nga rastet.

Rezulton se për vitin 2019 janë regjistruar nga Seksioni i Krimit Ekonomik, Financiar dhe Kibernetik procedimet penale të ardhura nga burimet si vijon:

- 4** procedime penale kane filluar kryesisht nga prokurorët e Seksionit të Krimit Ekonomik, Financiar dhe Kibernetik
- 305** procedime penale mbi bazën e referimeve të ardhura nga Policia e Shtetit
- 31** procedime penale nga organet tatimore dhe **9** procedime penale nga organet doganore
- 104** procedime penale nga shtetas dhe nëpunës të tjerë publikë.

Si rezultat i punës intensive të Prokurorëve, Of.Pol.Gjyqësore dhe koordinimit me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit, për vitin 2019 është arritur të përmirësohet puna dhe treguesit e ndjekjes penale për këtë vepër, pasi është arritur të goditet në disa raste kriminaliteti. Në kuadër të bashkëpunimit me Policinë e Shtetit, janë kryer veprime të rëndësishme në kuadër të hetimit të procedimeve penale kundër korrupsionit nga Seksioni i Krimit Ekonomik. Këtu vlen të përmenden këto raste:

Në kuadër të Procedimit Penal Nr.662 datë 04.04.2019, është bërë ndalimi i shtetasit R. Y., i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” të parashikuar nga nenet 189 dhe 248 të Kodit Penal. Po kështu janë caktuar në mungesë masat e sigurimit “arrest me burg” për shtetasit: 1) V. Z. për veprat penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” dhe “Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga nenet 244 dhe 189 të K.Penal. 2) E. K. për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” dhe “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” të parashikuar nga nenet 248 189 dhe 259 të K.Penal. Nga ana tjetër është ndjekur në gjendje të lirë shtetasja K. P., për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” të parashikuar nga nenet 189 dhe 248 të Kodit Penal.

Në kuadër të Procedimit Penal Nr.2656 datë 04.12.2018, pas një pune intensive disa mujore me përdorimin e metodave speciale të hetimit, është bërë Zbatimi i Urdhrit të Prokurorit për Ekzekutimin e Vendimit Nr.104/1 datë 17.04.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për caktimin e masës së sigurisë “Arrest me Burg” për shtetasin: A.P.. Këtij shtetasi nga kontrolli i ushtruar iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale dy pasaporta dhe dy karta ID greke, si dhe dy aparate telefon “Samsung”.

Në kuadër të Procedimit Penal Nr.1164 datë 21.06.2019, më datë 20.06.2019, u arrestua në flagrancë për veprat penale të “Kontrabandë me mallra që paguhet akcizë”, “Tregëtim dhe transportim i mallrave që janë kondrbandë”, të parashikuar nga neni 172 dhe 178, të K. Penal, shtetasit Q.S. Arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi është bërë pasi në datën 20.06.2019, ora 21:30 gjatë kontrollit në autobuzin e tij me targa maqedonase i janë gjetur dhe sekuestruar 3090 copë paketa cigare me pullë fiskale maqedonase të cilat i kishte fshehur në tavanin e autobuzit për t’i kondrbanduar në Itali.

Në kuadër të procedimit 1878 të vitit 2018, pas një hetimi disa mujor me metoda speciale të hetimit nga ana e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

- A. Gj., me detyrë shofer pranë Drejtorisë UKD sh.a. Durrës, me automjetin e kësaj ndërmarrje shpërndante ujë për subjekte dhe persona të interesuar kundrejt pagesës duke shpërdoruar detyrën. Për veprat penale “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën” dhe “Shpërdorim i detyrës” të parashikuar nga nenet 135 e 248 të Kodit Penal.
- S. P., ky shtetas vidhte ujë në tubacionin e UKD sh.a. Durrës duke e tregtuar me pas nëpër subjekte dhe persona të interesuar. Për veprën penale “Vjedhje” e parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.

Në kuadër të Procedimit Penal Nr.1580 datë 11.08.2019, më dt. 09.08.2019 është bërë ndalimi i shtetasve:

- R. K., punonjës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës-Durrës, për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës” “Falsifikim i dokumenteve parashikuar nga neni 259,248 e186/3 i Kodit Penal.

Më pas janë ndaluar edhe shtetasit:

- A. I., i datëlindjes 14.12.1977, banues ne Durrës, me detyrë Zv.Drejtor pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës.
- F. R., me detyrë specialist pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës. Për veprat penale të “Korrupsionit pasiv nga persona që ushtrojnë funksione publike” “Shpërdorimit të detyrës” “Falsifikim i dokumenteve parashikuar nga neni 259,248 e186/3 i Kodit Penal.

Këta tre shtetas duke qënë në funksionet e mësipërme kanë paisur me leje legalizimi dy shtetasit e mëposhtëm me dokumenta të falsifikuara të një objekti me sipërfaqe

123 metra katror dhe truall 500 metra katror në lagjen Nr.13 në zonën e plazhit Durrës dhe konkretisht, Xh. N dhe E. S., për veprën penale të “Vjedhjes me pasoja të rënda” prashikuar nga neni 134/3 i Kodit Penal.

Në kuadër të Procedimit Penal Nr.1976 datë 22.09.2019, më dt.20.09.2019 u bë ndalimi i shtetasve:

- L. K., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës Juridike dhe të Bashkëqeverisjes pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni, 248 i Kodit Penal.
- L. P., banues në Tiranë, me detyrë Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës. Ndalimi i tyre u bë për arsye se nga hetimet e kryera rezultoi se duke qenë në funksionin e mësipërm ka bërë regjistrim fillestar të një kontrate sipërmarrje dhe pajisje me certifikatë pronësie pa përmbyllur procedurën e hedhjes së të dhënave në regjistrin e pasurive të paluajtshme për subjektin “LURA” të zona e quajtur Gjiri i Lalëzit.

Po kështu është bërë shpallja në kërkim e shtetasit:

- F. Gj., Ish- Drejtor i ALUIZNI-t Durrës, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën” dhe “Falsifikimit të dokumenteve” parashikuar nga neni, 248, 135 dhe 186 të Kodit Penal. Shpallja në kërkim e tij u bë për arsye se nga hetimet e kryera ka bërë legalizim e një objekti i cili nuk ka ekzistuar kurrë me sipërfaqen 1080 m² tek fshati Arapaj/Durrës.

Në kuadër të Procedimit Penal Nr.1405 të vitit 2019, me dt.30.09.2019 u bë ndalimi i shtetasit:

- F. B, banues në Kalle, Dibër Peshkopi, për veprat penale të “Falsifikim i letrave me vlerë”, “Mashttrim” “Falsifikim i vulave dhe stampave” parashikuar nga neni 148, 143/2 e 190 të Kodit Penal. Ndalimi i tij u bë për arsye se në vijim të komunikatave të numrave unik: 201907060103; 201907060106.; 201907140055; 201907140057.; 201907140058.; 201907160069; 201907180054; 201907180053; 201907170030.; 201907200088; 201907200084; 201907220052; 201907220047.; nga hetimet e kryera rezultoi se ky shtetas gjatë muajit Korrik 2019 në Portin e Barit, Itali, ka falsifikuar 13 Polica Sigurimi për automjete të kompanive SIGAL dha ALBSIG.

Në kuadër të Procedimit Penal Nr.531 datë 13.03.2019, më datë 25.10.2019, u bë ekzekutimi i Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, Nr. 98/9 date 23.10.2019, për masat e sigurisë personale “Arrest në burg” për shtetasit:

- A. I., ish-Drejtori i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Durrës, i dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”.
- E. N., ish-Drejtori i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Durrës, e dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”
- S. I., ish-Kryetari i Komunës Ishëm, i dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”.
- Gj. B., ish Kryetari i Komisionit të Ndarjes së Tokës në fshatin Bizë, i dyshuar për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”.
- A. K., ish-Drejtori i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Durrës, për veprën penale i dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”.
- B. Z., ish Jurist ne Zyren Vendore te Regjistrimit te Pasurise se Paluajtshme Durrës, i dyshuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës” (e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se njëherë).
- M. D., ish Juriste ne Zyren Vedndore te Regjistrimit te Pasurise se Paluajtshme Durrës, e dyshuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës” (e kryer në bashkëpunim).

- R. P., ish Jurist ne Zyren Vendore te Regjistrimit te Pasurise se Paluajtshme Durrës, i dyshuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës” (e kryer në bashkëpunim).
- M. Z., Jurist në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Durrës, i dyshuar për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”.
- R. Z., ish-Hartograf në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Durrës, i dyshuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës” (e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë).
- D. K., ish-Hartograf në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Durrës, i dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”.
- E. Sh., anëtar i Komisionit të Ndarjes së Tokave në fshatin Bizë, i dyshuar për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”.
- L. M., anëtar i Komisionit të Ndarjes se Tokave ne fshatin Bizë, i dyshuar për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”.
- L. B., përfitues toke, i dyshuar për veprën penale “Mashtrimi”.
- G. P., përfitues toke, i dyshuar për veprat penale “Mashtrimi” paragrafi 2, 3 dhe “Falsifikimi i dokumenteve” i kryer në bashkëpunim.
- A. D., përfitues toke, i dyshuar për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” i kryer në bashkëpunim.
- L. N., përfitues toke, i dyshuar për veprat penale “Mashtrimi” paragrafi 2, 3 dhe “Falsifikimi i dokumenteve” i kryer në bashkëpunim.
- L. O., i dyshuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Përvetësimi parave ose mallrave që rrjedhin nga veprimtari kriminale” të parashikuara nga nenet 186/2 dhe 287/b-25 të K.Penal, administrator i shoqërie private.

Detyrim paraqitje para oficerit të policisë gjyqësore

- A. Ç., përfituese, e dyshuar për veprat penale “Mashtrimi” paragrafi 2, 3 i kryer në bashkëpunim, masë sigurimi “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.
- Sh. A., përfitues, i dyshuar për veprat penale “Mashtrimi” paragrafi 2, 3 i kryer në bashkëpunim, masë sigurimi “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.
- D. G., Juriste në Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Durrës, e dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, masë sigurimi “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.
- S. M., ish-Juriste ne Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Durrës, i dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, masë sigurimi “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.
- A. Th., ish-Juriste në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Durrës, e dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, masë sigurimi “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” parashikuar nga neni 234 të K. Pr. Penale.
- L. K., Përgjegjese e Zyres Juridike në Agjencia Shtetërore e Kadastres Durrës, e dyshuar për “Korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 259 K.Penal.
- G. B., përfitues, i dyshuar për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” i kryer në bashkëpunim.

Nga veprimet hetimore të kryera në funksion të procedimit penal Nr. 531/2019, pas një hetimi proaktiv duke aplikuar metodat speciale të hetimit, si kryerje përgjimesh telefonike, filmime, përgjime ambientale, vëzhgime, rezultoi se shtetasit e mësipërm në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë tjetërsuar sipërfaqe toke prej 68000 m², nga tokë shtetërore pa frut në tokë arë dhe ia kanë shpërndarë personave të ndryshëm kundrejt përfitimit. Këtë aktivitet e kanë realizuar nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve, si të akteve të marrjes së tokës në pronësi, kartelave të pasurive në Regjistrat e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës. Këtë

sipërfaqe toke ja u kanë shpërndarë personave me banim në Durrës, të cilët nuk u takonte të merrnin tokë në pronësi sipas ligjit.

Në kuadër të Procedimit Penal Nr.831 datë 09.05.2018, të regjistruar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, **më datë 01.11.2019** u bë sekuestrimi 18 pasurive të paluajtshme, 5 apartamente me sipërfaqe totale 413.807m² dhe 13 garazhe me sipërfaqe totale 622.707 m² këto të përkthyer me një vlerë monetare në total rreth 700.000 euro dhe një automjet i tipit Daimler Chrysler ML 320 me një vlerë rreth 40.000 euro. Këto pasuri figurojnë të regjistruara në emër të shtetasit F. F. M., i dënuar nga Autoritetet e Drejtësisë Italiane si pjesë e klaneve “Kamorriste” në zonën e Napolit Itali.

Më datën 14.12.2019, në kuadër të procedimit penal nr.2466 të vitit 2019 u bë ndalimi i shtetasve që me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë sjellë pasoja të cilat u identifikuan nga tërmeti i datës 26.11.2019, si më poshtë:

- **R. Xh.**, për veprën penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” parashikuar nga neni 79 gërma “dh” të K.Penal.
- **A. O.**, për veprën penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” parashikuar nga neni 79 gërma “dh” të K.Penal.
- **K. H.**, Përgjegjës pranë Shtepisë së Pushimit të Ministrisë së Brendshme, për veprën penale “Vrasje me dashje” parashikuar nga neni 76 i K.Penal.
- **A. I.**, Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Shpallur në kërkim me shkresën nr. 11978 datë 14.12.2019.
- **A. D.**, Drejtor i Shtëpisë së Pushimit të Ministrisë së Brendshme, për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal.
- **N. I.**, eksperte topografe, për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve” parashikuar nga neni 186/3 i K.Penal.
- **K. L.**, inspektor pranë IMT-së Bashkia Durrës, për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal.
- **A. Q.**, punonjës i ALUIZNI Durrës, për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal.
- **D. C.**, ekspert ndërtimi, për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Si dhe janë shpallur në kërkim për zbatim të Urdhrave të ndalimit shtetasit me iniciale: D. Q. e datëlindjes 1969, A. Q., i datëlindjes 1966, A. Ç. i datëlindjes 1967, F. GJ., i datëlindjes 1971, R. Sh. i datëlindjes 1954, A.D, i datëlindjes 1990, A. M. i datëlindjes 1987, S.B. i datëlindjes 1990, A.T. i datëlindjes 1976, për veprat penale “Vrasje me dashje”, “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga nenet 79/dh, 76 e 248 të Kodit Penal.

Seksioni për hetimin e Krimin Ekonomik, Financiar dhe Kibernetik në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2019 ka marrë vendim për sekuestro preventive në 4 procedime penale, konkretisht ka vendosur masën e sekuestros preventive për rastet e mëposhtme:

- Për veprat penale të “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga nenet 248-25 dhe 186 të K.Penal, ka vendosur sekuestro preventive mbi objekt me gjatësi 18m dhe gjerësi 7.4 m.
- Për veprat penale të “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve”, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga nenet 248, 186 pgr. 2, 3, 259 dhe 287/b -25 të K.Penal, ka vendosur sekuestro preventive mbi pasuri të paluajtshme me sipërfaqe 11000 m², me sipërfaqe 7000 m², arë me sipërfaqe 4.705 m², arë me sipërfaqe 9300 m², arë me

sipërfaqe 15000 m², arë me sipërfaqe 9700 m², me sipërfaqe 470 m², sipërfaqe truall 260 m² sipërfaqe ndërtesë 110 m², me sipërfaqe 12.060 m².

- Për veprën penale të “Pastrimi i produkteve te veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 të K.Penal, ka vendosur sekuestro preventive mbi pasuri Sip.86.538 m² apartament (sip. në bashkëpronësi është 11,495 m² + 72.7141 m² tarracë), sip.69.9 m² apartament (sip. në bashkëpronësi është 7.684 m²), sip.86.025 m² apartament, sip.80.05 m² apartament, sip.91.294 m² apartament, sip.13.525 m² garazh, sip.13.525 m² garazh, sip.28.673 m² garazh, sip.29.044 m² garazh, sip.25.576 m² garazh, sip.42,24 m² garazh, Sip.17.84 m² garazh, sip.32.33 m² garazh, sip.30.5 m² garazh, sip.15.25 m² garazh, sip.17.08 m² garazh, sip.285.22 m² garazh, sip.44 m² garazh, automjet tip Daimler Chrysler, Model ML 320 CDI, llogaritë bankare në Intesa Sanpaolo Bank, Banka Italo Shqiptare, Banka Amerikane e Investimeve, Alpha Bank, Credins Bank, Procredit Bank, Tirana Bank, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka e Kreditit Shqiptar, Banka e Bashkuar Shqiptare, Banka e Parë e Investimeve, Raiffeisen Bank, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Societe Generale Albania, Banka Asc Union.

- Për veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 të K.Penal, ka vendosur sekuestro preventive mbi pasuri pemishte + truall, 600 m² truall, së bashku me një banesë, truall, njësi, apartament, njësi me sipërfaqe 70.85m², apartament, automjet, llogari bankare në monedhën Lek në Bankën Ndërkombëtare Tregtare, llogari bankare në monedhën Euro në Bankën Ndërkombëtare Tregtare, llogari bankare në monedhën Lek në Bankën Ndërkombëtare Tregtare, llogari bankare në monedhën Lek në Bankën Ndërkombëtare Tregtare, llogari bankare në monedhën Lek në Bankën Ndërkombëtare Tregtare, llogari bankare në monedhën Lek në Bankën Amerikane të Investimeve, llogari bankare në monedhën Euro në Bankën Amerikane të Investimeve, llogari bankare në monedhën Euro në Bankën Amerikane të Investimeve, llogari bankare në monedhën Lek në Bankën Amerikane të Investimeve, llogari bankare në monedhën Lek në bankën Amerikane të Investimeve, llogari bankare në monedhën Euro në Bankën Amerikane të Investimeve, llogari bankare në monedhën Lek në Bankën Amerikane të Investimeve, llogari bankare në monedhën Euro në Bankën Amerikane të Investimeve, llogari bankare në monedhën Lek në NBG Bank, llogari bankare në monedhën Euro në NBG Bank, llogari bankare në monedhën Lek në NBG Bank, llogari bankare në monedhën Euro në FIBank, llogari bankare mbështetëse bashkëemërore në monedhën Lek në NBG Bank.

Në lidhje me Procedimin penal Nr.532 të vitit 2011, të vitit 2011, dërguar për gjykim më datë 08.02.2016, në bazë të nenit 36/1 gërma “b” të Kodit Penal dhe 275/2 të Kodit të Procedurës Penale është vendosur konfiskimi i pasurive mbi të cilat është vendosur sekuestro preventive sipas vendimit nr.634, datë 18.09.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës:

-Sipërfaqes së tokës arë prej 8000 m², ndodhur në zonën kadastrale 1925 me nr.Pasurie 52/1, vol. 4, fq. 207 që përfshin fshatin Hamallaj.

-Sipërfaqes së tokës are prej 10200 m² ndodhur në zonen kadastrale 1925 me nr.Pasurie 52/3, vol. 4, fq. 209 që përfshin fshatin Hamallaj.

-Sipërfaqes së tokës arë prej 10500 m² ndodhur në zonën kadastrale 1925 me nr.Pasurie 52/4, vol. 4, fq. 210 që përfshin fshatin Hamallaj.

-Sipërfaqes së tokës arë prej 153800 m² ndodhur në zonën kadastrale 1925 me nr.Pasurie 53/1, vol. 4, fq. 211 që përfshin fshatin Hamallaj.

-Sipërfaqes së tokës arë prej 158300 m² ndodhur në zonën kadastrale 1925 me nr.Pasurie 53/2, vol. 4, fq. 212 që përfshin fshatin Hamallaj.

-Sipërfaqes së tokës arë prej 30600 m² ndodhur në zonën kadastrale 1925 me nr.Pasurie 53/3, vol. 4, fq. 213 që përfshin fshatin Hamallaj.

-Sipërfaqes së tokës arë prej 105500 m² ndodhur në zonën kadastrale 1925 me nr.Pasurie 54/1, vol. 4, fq. 214 që përfshin fshatin Hamallaj.

-Sipërfaqes së tokës are prej 105500 m² ndodhur në zonën kadastrale 1925 me nr.Pasurie 52/2, vol. 4, fq. 215 që përfshin fshatin Hamallaj.

Vendimi ka marrë formë të prerë me vendimin penal nr.10-2019-2147 datë 14.11.2019 të Gjykatës së Apelit Durrës.

2. LUFTA KUNDËR LËNDËVE NARKOTIKE

Veprat penale në fushën e narkotikëve, kanë pësuar një ulje gjatë këtij viti, fakt i cili shpjegohet dhe me rritjen e luftës parandaluese të kryer nga policia e shtetit, nëpërmjet kontrollit të territorit kundër kultivimit të kanabisit. Konstatohet se shpesh referimet bëjnë fjalë për përdorues të lëndëve narkotike. Në këtë drejtim duhet punuar më fort për evidentimin në një shkallë më të gjerë të personave të angazhuar me prodhimin dhe shitjen e narkotikëve. Vlen të përmendet si hetim i suksesshem në këte fushë:

-Procedimi penal nr.2476 i vitit 2018, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga nenet 278/6, 279, 284, 283/2 dhe 300, në ngarkim të 8 personave, me masa sigurimi “Arrest në burg”, i shoqëruar edhe me sekuestrimin e sasi prej 20.63 kg hashash.

- procedimi penal nr. 1990 datë 25.09.2018, që bëjnë fjalë për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal. Në funksion të hetimeve të këtij procedimi penal, është autorizuar kryerja e veprimeve simuluese për personat e dyshuar dhe është vendosur edhe agjenti i Policisë Gjyqësore nën mbulim.

- procedimi penal me nr. 2356 viti 2018 që bën fjalë për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/2 i K.penal në ngarkim të shtetasve T. L. dhe A.B.Në funksion të hetimeve është bërë e mundur kapja dhe sekuestrimi i një sasi lende prej 2 kg kokainë.

3. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është angazhuar maksimalisht, që gjatë veprimtarisë së saj të mbajë parasysh mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të drejtës kushtetuese të pronës private dhe shtetërore nga veprimtaritë kriminale dhe të kundraligjshme që kanë si qëllim çënimin e tyre. Në këtë kuadër Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka forcuar bashkëpunimin me agjencitë e tjera ligjzbatuese me qëllim hetimin e plotë të veprave penale në këtë fushë. Gjithashtu është mbajtur parasysh në hetimet paraprake, në mënyrë të veçantë zbatimi i kushteve dhe kriterëve ligjore që kanë të bëjnë me parimin e ligjshmërisë, si dhe respektimin dhe zbatimin e të drejtave të viktimave, në reflektim të ndryshimeve të reja të Kodit të Procedurës Penale. Një kujdes i veçantë në këtë aspekt është mbajtur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në kërkesat e saj për të pandehurit e mitur dhe të pandehurat femra ku në shumicën e rasteve lidhur dhe nga rrezikshmëria shoqërore e tyre nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë kërkuar masa sigurimi të ndryshme nga ajo e arrestit me burg si dhe dënime alternative. Kjo në funksion të qëllimit të vetëm ligjor të ri-integritimit në shoqëri të kësaj kategorie të pandehurish.

4. TË MITURIT DHE GRUPET VULNERABËL, SI TË PANDEHUR DHE VIKTIMAT

Mbrojtja e të drejtave të të miturve në procesin penal ka qenë në fokusin e punës së organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës gjatë vitit 2019. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ushtron veprimtarinë e tij Seksioni për Hetimin e veprave penale me persona të mitur, i përbërë nga tre prokurorë. Gjatë vitit 2019 Objekt i veprimtarisë së këtij Seksioni janë dhe trajtimi i kërkesave në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, ekzekutimi i vendimeve penale të formës së prerë, kërkesave në fazën e ekzekutimeve, si dhe i kërkesave të tjera të drejtpërdrejta në gjykatë.

Prokurorët e këtij seksioni, kanë trajtuar me profesionalizëm procedimet penale në hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur, person nën hetim, i dëmtuar ose dëshmitar. Gjatë vitit 2019 ky seksion ka zbatuar me rigorozitet Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, zbatimin e të cilit ka nisur në janar të vitit 2018. Ky seksion ka zbatuar me përpikmëri të gjitha kërkesat ligjore për respektimin në maksimum të të drejtave të miturve në konflikt me ligjin. Me hyrjen në fuqi të ligjit 97/2016 është caktuar edhe prokurori

koordinator për të miturit, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 5 datë 26.10.2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”. Në të gjitha rastet nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është siguruar pjesëmarrja e psikologut gjatë hetimit si dhe është ruajtur sekreti i informacionit dhe ndalimi i publikimit të akteve hetimore të mbledhura nga policia gjyqësore lidhur me provat e mbledhura për hetimin në ngarkim të të pandehurve të mitur. Në çdo rast prokurori i seksionit për hetimin e krimin të kryer nga të miturit ka njoftuar pa vonesë prindërit ose përfaqësuesit ligjorë të tyre duke ju përmbajtur parimit më të lartë të interesit të të miturit. Vlen të përmendet se nga seksioni për të mitur ka filluar zbatimin e aplikimit të shmangies së të miturve nga dënimi, ku treguesit do të paraqiten më poshtë në mënyrë më të detajuar. Gjatë vitit 2019 ky seksion ka trajtuar edhe çështjet e ardhura për kompetencë lëndore nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykata e Shkallës së Parë Kavajë.

Megjithëkëtë gjatë punës janë hasur edhe problematika që kanë të bëjnë sidomos me të miturit të cilët janë përsëritës në kryerjen e veprave penale, kanë qenë të dënuar më parë dhe në rastet e kapjes në flagrancë, të kryerjes së një vepre tjetër penale është proceduar dhe me arrestimin e tyre. Në shumicën e rasteve këto arrestime janë përligjur dhe nga gjykata.

Për këtë problematikë bëhet shkak mosekzistenca e institucioneve përkatëse për trajtimin e këtyre të miturve të cilët në një farë mënyre edhe janë abandonuar nga prindërit e tyre dhe si mënyrë mbijetese kanë kryerjen e veprave penale kryesisht atë të vjedhjes.

Përsa i përket hetimit të çështjeve penale me të mitur është e domosdoshme krijimi i kushteve dhe ambienteve të përshtatshme për pyetjen e të miturve dhe sidomos të të miturve viktimë të veprave penale dhe të abuzuar seksualisht. Kjo është domosdoshmëri dhe kërkesë e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Lidhur me gjykimin e çështjeve penale me të mitur ka patur raste problematike lidhur me caktimin e dënimit për të miturit sidomos për ato që janë përsëritës në kryerjen e veprave penale duke qenë se në këtë kod ka kontradikta përsa i përket caktimit të dënimit sidomos për llojin e dënimit me burgim dhe për rastin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim.

Më poshtë po ju parashtrojmë treguesit e punës së Seksionit për të miturit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës përsa i përket hetimit dhe përfundimit të çështjeve penale përgjatë vitit 2019:

- Gjatë vitit 2019, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë regjistruar gjithsej 67 çështje penale me 72 të pandehur të mitur, pjesa më e madhe e të cilëve është e grupmoshës 16-18 vjeç dhe 6 prej tyre janë përsëritës (kryesisht për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i K.Penal) ku në këtë periudhë kohore janë mbartur nga viti 2018, gjithsej **89** çështje penale me autor veprash penale persona të mitur.
- Gjatë vitit 2019, nga Prokurorët e seksionit të hetimit të veprave penale për të miturit, janë përfunduar gjithsej **47** çështje penale, nga të cilat **26** prej tyre janë përcjellë **për gjykim** në seksionin e të miturve pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, **18** çështje penale janë pushuar. Nga 18 çështje të pushuara, 16 prej tyre janë pushuar për shkak të nenit 67 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (3 raste në aplikim të nenit 67 të KDPM është vendimmarrje mosfillim).
- Në lidhje me masat e sigurimit personal nga Prokurorët e seksionit të hetimit të veprave penale për të miturit, përgjatë vitit 2019 janë ndjekur me masë sigurimi personal **“Arrest në burg” 11** të pandehur, ndërsa për **7** të pandehur të tjerë janë ndjekur me masë sigurimi personal **“Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”**

Të pandehur të mitur hetuar	Të pandehur të mitur dërguar gjyqit	Të pandehur të mitur dënuar
72	33	14

Kërkesa e Prokurorit për dënimin e të miturve								Vendimi i Gjykatës për dënimin e të miturve								
Gjobë	B u r g i m						Perjashtim nga denimi	Gjobë	B u r g i m						Perjashtuar nga denimi	
	Paraburgim	Minimum	Mesatar	Maksimum	Neni 59	Denime alternative			Paraburgim	Minimum	Mesatar	Maksimum	Neni 59	Denim alternative		
-	-	3	-	-	7	4	-	-	-	2	-	-	8	4	-	
Gjithsej: 14								Gjithsej dënime: 14								

Kërkesa të Prokurorit për Masa Sigurimi të pandehur të mitur								Vendime të Gjykatës për Masa Sigurimi të pandehur të mitur							
Arrest në Burg	Arrest Burg Mungesë	Arrest në Shtëpi	Arrest me Afat	Vendosja në mbikqyrje	Detyrim Paraqitje Pol. Gjyqësore	Gjithësej Masa Shtrenguese	Masa Ndaluese	Arrest në Burg	Arrest Burg Mungesë	Arrest në Shtëpi	Arrest me Afat	Vendosja në mbikqyrje	Detyrim Paraqitje Pol. Gjyqësore	Gjithësej Masa Shtrenguese	Masa Ndaluese
11	-	-	-	-	7	18	-	11	-	-	-	-	7	18	-

Si më poshtë jepet tabela treguese e numrit të viktimave:

Neni K.Penal	Të mitur viktima
84	2 të mitur
86	1 i mitur
88	2 të mitur
88/a	4 të mitur
89	5 të mitur

90	6 të mitur
92	3 të mitur
100/2	6 të mitur
108/1	3 të mitur
109/2	1 i mitur
110/2	1 i mitur
121/a	2 të mitur
124	1 i mitur
124/b	2 të mitur
130/a/4	2 të mitur
134	15 të mitur
275	2 të mitur
290	22 të mitur
292	1 i mitur
293/b	1 i mitur

5. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, gjatë vitit 2019 ka patur marrëdhënie korrekte dhe pozitive me institucionet e tjera, të cilat janë të përfshira dhe të lidhura me punën tonë. Në këto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato që lidhen me:

**Këshillin e Lartë të Prokurorisë
Prokurorinë e Përgjithshme
Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës
Prokurorinë e Apelit Durrës
Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës
Institucione të tjera në nivel lokal**

Raportet me Këshillin e lartë të Prokurorisë, gjatë vitit 2019, që është viti i parë i funksionit të këtij organi të ri pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, është vërejtur një raport shumë korrekt i cili konsiston në gatishmërinë e plotë për bashkëpunim dhe ndihmë për zbatimin e të gjithë detyrimeve ligjore përkatëse me përpikmëri.

Raportet me Prokurorinë e Përgjithshme, gjatë vitit 2019 është vërejtur një raport shumë i ngushtë bashkëpunimi i cili konsiston në gatishmërinë e plotë për bashkëpunim dhe ndihmë nga të gjitha drejtoritë pranë Prokurorisë së Përgjithshme për zbatimin e të gjithë detyrimeve ligjore me përpikmëri.

Bashkëpunimi i sektorëve të ndryshëm brenda institucionit tonë (si Zyra e regjistrarit-Arkiva-Kryesekretaria), gjithashtu dhe bashkëpunimi me zyrat e drejtorive në Prokurorinë e Përgjithshme bëri të mundur raportimin në kohë të një materiali voluminoz me të dhëna të detajuara, sipas kërkesës së drejtuar.

Gjithashtu nga ana e institucionit tonë, është për t'u vlerësuar gatishmëria dhe disponibiliteti i strukturës mbështetëse për çdo kërkesë të karakterit të ngutshëm, të cilave i jemi përgjigjur me korrektësi dhe brenda afateve të përcaktuara.

Raportet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, gjatë vitit 2019 kanë qenë korrekte dhe ligjore duke u bazuar në korrektesën e ndërsjelltë dhe reciproke. Me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale, me Ligjin nr. 35/2017 datë 05.05.2017, hyrë në fuqi më datë 01.08.2017 tashmë ka ndryshuar roli i Prokurorit në hetim dhe gjykim, dhe për këtë shkak

është dyfishuar koha që prokurori merr pjesë në gjykim, duke sjellë si rrjedhojë edhe ngarkesë në menaxhimin e dosjeve në fazën e hetimit. Përgjithësisht prokurorët kanë qenë korrekt në pjesëmarrjet në gjykim. Ka patur edhe raste të mungesave të prokurorëve, të cilat kanë ardhur nga shkaqe objektive, si pjesëmarrja në trajnime, përplasjet me orare të tjera gjyqësore (per shkak të mungesës së sallave) apo kryerje e veprimeve hetimore me përparësi. Rezulton se ka patur raste të kthimit të dosjeve për plotësim si të atyre të dërguara për gjykim ashtu dhe për pushim.

Në zbatim të dispozitave procedurale penale nga ana jonë është analizuar çdo rast, duke kryer veprimet hetimore kur vendimi i gjykatës ka qenë i bazuar, si dhe është ushtruar ankim ndaj vendimeve gjyqësore në rastet kur në vlerësimin e prokurorit vendimet kanë qenë të pambështetura në ligj.

Ka patur bashkëpunim dhe mirëkuptim të plotë me zv/Kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në rastet e trajtimit dhe përmirësimit të problematikave të veçanta që janë shfaqur gjatë punës.

Trajtimin më evident të të dhënave që kanë rezultuar në kërkesat drejtuar gjykatës do ta trajtojmë në materialin vijues.

Raportet me Prokurorinë e Apelit Durrës, vazhdojnë të jenë raporte reciproke dhe të ndërsjellta duke mbajtur kontakte të vazhdueshme në funksion të përfaqësimit të akuzës lidhur me çështjet penale të ankimuar nga Prokurorët pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Rezulton se Prokurorët pranë Gjykatës së Apelit Durrës në shumicën e rasteve kanë përkrahur ankimet e bëra nga ana e Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës si në Gjykatën e Apelit Durrës ashtu dhe duke ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Po kështu vetëm në raste të veçanta rezulton se në disa raste nga prokurorët e Apelit nuk është bërë përkrahja e ankimit të ushtruar nga Prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës duke hequr dorë nga ankimi.

Raporti me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, gjatë vitit 2019 përveç respektimit me rigorozitet të detyrimeve ligjore dhe në funksion të rritjes së cilësisë së hetimit është synuar krijimi i një raporti të ngushtë bashkëpunimi me të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit që veprojnë në rrethin e Durrësit, si Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut, etj. Pavarësisht sa më sipër gjatë këtij viti janë evidentuar edhe të meta të cilat janë trajtuar dhe orientuar drejt zgjidhjes së tyre si ato që lidhen me:

- kryerjen në kohë të veprimeve të para dhe të papërsëritshme,
- dorëzimin tek prokurori sipas afateve të përcaktuara në urdhrat për kryerjen e veprimeve hetimore,
- dorëzimin brenda afatit procedural të akteve që përmbajnë kontrollime, sekuestrime etj., - problematikë e vazhdueshme është lëvizja e shpeshtë e Oficerëve të Policisë Gjyqësore në detyra të tjera apo sektorë të tjerë duke sjellë si pasojë dorëzimin e dosjeve të deleguara;
- mungesën në organikën e Oficerëve të Policisë Gjyqësore, në sektorë të veçantë kryesisht në Seksionin që mbulon krimin ekonomik, financiar dhe kibernetik,
- Raporti me institucionet e tjera vazhdon të jetë një raport korrekt, institucional dhe i ndërsjellë me organet e qeverisjes vendore, etj.

6. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Marrëdhënies Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme si hallka kryesore lidhëse për marrëdhëniet ndërkombëtare të Prokurorisë. Në këtë kuadër ka ekzistuar një bashkëpunim i mirë me shtetet e huaja si për ekzekutimin e letërporosive të ardhura nga jashtë, por edhe të atyre të përcjella nga ana jonë.

Rol i veçantë i është kushtuar ekstradimeve, urdhrave të kërkimit ndërkombëtar, duke patur parasysh respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të drejtave të njeriut dhe parimin e reciprocitetit.

7. PËRDORIMI I METODAVE SPECIALE HETIMORE DHE HETIMET PROAKTIVE

Në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për vitin 2019 ka funksionuar Seksioni për hetimin e Krimit Ekonomik, Financiar dhe Kibernetik, ku objektiv kryesor i punës së kësaj njësie ka qenë goditja e veprave penale të korrupsionit dhe veprave penale në kompetencë të kësaj njësie të kryera në fushën e ekonomisë, ku në disa raste të hetimit të këtyre veprave janë përdorur metoda speciale të hetimit siç janë ato të përgjimeve, vëzhgimeve etj. Këto raste kanë qenë rezultative dhe në disa raste për shkak të aplikimit të këtyre metodave është proceduar me arrestin në flagrancë të autorëve të këtyre veprave penale.

Mund të përmendim raste si më poshtë:

1.Procedimi penal nr.2466 e vitit 2019, regjistruar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", "Ndërtimi i paligjshëm", "Vrasja me dashje", "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese";, parashikuar nga neni 248, 199/a, 76 e 79/dh të Kodit Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike.

2.Procedimi penal nr.2042 e vitit 2019, regjistruar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", "Ndërtimi i paligjshëm", parashikuar nga neni 248 e 199/a të K.Penal.

Lloji i përgjimit:Komunikime telefonike.

3.Procedimi penal nr.531 e vitit 2019, regjistruar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", "Falsifikimi i dokumentave", "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike"parashikuar nga neni 248, 186 dhe 259 i Kodit Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike.

4.Procedimi penal nr.1990 e vitit 2018, regjistruar për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike, përgjim në ambiente publike.

5.Procedimi penal nr.275 e vitit 2018, regjistruar për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike, përgjim në ambiente publike.

6. Procedimi penal nr.2678 e vitit 2018, regjistruar për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike, përgjim në ambiente publike.

7.Procedimi penal nr.681 e vitit 2019, regjistruar për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike, përgjim në ambiente publike.

8.Procedimi penal nr.2476 e vitit 2019, regjistruar për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit" , "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armeve te ftohta", "Kultivimi i bimëve narkotike"parashikuar nga neni 283, neni 278, neni 279, neni 284 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike, përgjim në ambiente publike.

9.Procedimi penal nr.1987 i vitit 2019, regjistruar për veprën penale "Vepra të turpshme" parashikuar nga neni 108/2 i K.penal.

Lloji i përgjimit: Përgjim ambiental.

10.Procedimi penal nr.204 i vitit 2019, regjistruar për veprën penale "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur" parashikuar nga neni 100/2 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Përgjim ambiental.

11.Procedimi penal nr.2334 i vitit 2019, regjistruar për veprën penale "Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura" parashikuar nga neni 102/1 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike.

12.Procedimi penal nr.2102 e vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Prodhimi dhe mbatja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, “Mosbindja ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik”, “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 278, 242 e 300 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Kounikime telefonike.

13. Procedimi penal nr.1316 i vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Prodhimi dhe mbatja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” parashikuar nga neni 278 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Përgjim në ambiente publike.

14.Procedimi penal nr.1148 e vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Prodhimi dhe mbatja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” parashikuar nga neni 278 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike, përgjim në ambiente publike.

15.Procedimi penal nr.681 e vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike.

16.Procedimi penal nr.1082 i vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotikëve”, “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotikëve”, parashikuar nga neni 284 e 283 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike.

17. Procedimi penal nr.1878 i vitit 2018, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, “Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit”, “Vjedhja”, parashikuar nga neni 248, 135, 159 e 134/2 të K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike, përgjim në ambiente publike.

18.Procedimi penal nr.1940 i vitit 2018, regjistruar për veprën penale “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, parashikuar nga neni 172/3 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike.

19.Procedimi penal nr.2430 i vitit 2018, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike.

20.Procedimi penal nr.1492 i vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 e 259 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike, përgjim në ambiente publike.

21.Procedimi penal nr.2892 i vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore”, parashikuar nga neni 259 e 175 të K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike, përgjime në ambiente publike.

22.Procedimi penal nr.1589 i vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Mosbindja ndaj urdhërit të policisë së rendit publik”, “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 236, 242 e 300 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike.

23.Procedimi penal nr.404 i vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, “Prodhimi dhe mbatja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 79/dh e 278 të K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike, përgjime në ambiente publike.

24.Procedimi penal nr.74 i vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike.

25.Procedimi penal nr.1090 e vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit”, parashikuar nga neni 136 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Komunikime telefonike.

26. Procedimi penal nr.375 e vitit 2018, regjistruar për veprën penale “Shfrytëzimi i prostitucionit”, parashikuar nga neni 114/2 i K.Penal.

Lloji i përgjimit: Përgjime në ambiente publike.

27. Procedimi penal nr.1411 e vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134/3 i K.Penal.

Lloji i pëgjimit: Komunikime telefonike.

8. INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE UDHËZIMEVE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË NXJERRA NË BAZË TË TYRE

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është angazhuar dhe ka punuar në drejtim për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në lidhje me prioritetet në hetimin e veprave penale për të cilat nga Këshilli i Ministrave ka pasur rekomandime përkatëse duke unifikuar zbatimin e këtyre rekomandimeve me urdhrat dhe udhëzimet e dala nga Prokurori i Përgjithshëm.

Lidhur me mbikqyrjen e zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, në përmbushje të funksioneve që më janë ngarkuar me ligj, në cilësinë e Drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, vlerësoj se kam patur angazhim maksimal për të garantuar zbatimin korrekt të Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, nga të gjithë prokurorët dhe stafi i kësaj prokurorie. Konkretisht menjëherë pas marrjes së Udhëzimeve, urdhërohet kryesekretaria e prokurorisë me shpërndarjen e tyre, të të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe sipas rastit edhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë. Secili prej udhëzimeve punohet në mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve, për të cilat mbahet protokoll nga sekretarja e Drejtuesit të Prokurorisë.

Konkretisht janë nxjerrë urdhër “Mbi Organizimin e punës sipas seksioneve dhe ndarjen prokuror, of.pol.gjyqësore; Udhëzim i përgjithshëm me karakter detyrues (posta sekrete), Urdhër i brendshëm” Për shpërndarjen e çështjeve për periudhën e pushimeve vjetore Gusht 2019; Urdhër- Për miratimin e lejeve vjetore dhe mbarëvajtjen e punës për muajin Gusht 2019; Urdhër mbi- Riorganizimin e punës sipas seksioneve dhe ndarjen prokuror, of.pol.gjyqësore; Urdhër mbi- Administrimin e çelësave të serverit të institucionit etj., në total 41 urdhra dhe udhëzime.

9. INFORMACION STATISTIKOR MBI ÇËSHTJET PENALE QË LIDHEN ME PROCESIN E VERIFIKIMIT TË INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE

Lidhur me hetimin e veprave penale që lidhen me procesin e verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike rezultojnë që për vitin 2019 nuk ka patur procedime penale, të ardhura për kompetencë nga Drejtoria e Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

10. PRIORITETET E PROKURORISË GJATË VITIT 2019

- Prioritet i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2019 ka qenë dhe rritja e përgjegjësisë në mbrojtjen e të drejtave të individit dhe respektimit të dinjitetit, privatësisë, sigurisë personale të personave të dëmtuar nga veprat penale, ku në të gjitha rastet prokurori i ka njohur me të drejtën që ato kanë në procesin penal, në zbatim të dispozitave procedurale përkatëse të ligjit 35/2017 hyrë në fuqi më datë 01.08.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Kodin e Procedurës Penale”. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në këtë drejtim vlerësojmë se ka përmbushur detyrimet ligjore që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të këtyre subjekteve, me qëllim sigurimin e informimit, këshillimit të viktimave të krimit me fokus të veçantë viktimat në moshë të mitur, me aftësi të kufizuar, viktimat e dhunës në familje, shfrytëzimit seksual, etj.

- Një vëmendje të veçantë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës i ka kushtuar dhe aksesit të publikut për informacion, në këtë pikë është zbatuar me rigorozitet dispozita ligjore për të drejtën e informimit, ku në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2019 është caktuar një prokuror për të informuar të gjithë ata që kanë shprehur interes për të marrë informacion lidhur me punën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, veprim ky i koordinuar edhe me strukturat përkatëse pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
- Një ndër pikat lidhur me prioritetet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka qenë kërkesa ndaj prokurorëve për të respektuar me rigorozitet kodin e etikës. Gjatë vitit 2019 ka rezultuar se në përgjithësi nga gjithë trupa e prokurorëve, of.pol.gjyqësore dhe administratës në përgjithësi është respektuar kodi i etikës.
- Po kështu prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në mënyrë vazhduese gjatë vitit 2019 kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës si dhe në trajnime të organizuara nga OPDAT, PAMECA, EURALIUS etj.

11. PROBLEMATIKAT E HASURA

- Gjatë vitit 2019 është vërejtur si problematikë, numri i ulët i kallëzimeve dhe referimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe krimin ekonomik në përgjithësi.
- Vazhdon të ndiqet e njëjta metodë pune nga ana e D.P.Doganave lidhur me mosdërgimin në kohë të kallëzimeve lidhur me veprat penale të kryera në këtë sektor. Megjithëse në mënyrë të përsëritur është kërkuar që kallëzimet penale të dërgohen në kohë, sërish ka ndodhur që materialet të mbahen në dorë për një periudhë të gjatë pa asnjë veprim në DPD dhe dërgohen pas dy tre ose më shumë vitesh në Prokurori deri në limitet e parashkrimit të afateve të ndjekjes penale.
- Evidentohet një numër i madh referimi i veprave penale nga ana e D.R.Tatimeve të cilat përgjithësisht rezultojnë të jenë referime të bazuara në ligj dhe prej tyre janë dërguar një numër i konsiderueshëm për gjykim.
- Për këtë sektor të administratës ka rezultuar se nuk ka patur referime për veprën penale të “moskryerja e detyrave nga organet tatimore” apo veprave penale korruptive. Është mbajtur parasysh që në procedimet penale në fushën e tatimeve sikurse edhe në procedimet e tjera, të kryhen sekuestime në funksion të hetimit paraprak me vendim gjyqësor i pasurive të paluajtshme të subjekteve të veprës penale, me qëllim garantimin e pagimit të dënimit me gjobë dhe detyrimeve të tjera.
- Evidentohet një rritje për sa i përket numrit të referimeve të veprave penale të korrupsionit apo vepra të tjera penale nga ana e sektorit të SHÇBA-së pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës, gjithsej 16 referime që janë kryer për vitin 2019, nga të cilat 11 procedime penale janë regjistruar dhe 5 janë mosfilluar.
- Evidentohen raporte bashkëpunimi të mira me SHISH Dega Durrës, prej të cilës janë dërguar 8 informacione të cilat më pas, duke angazhuar Policinë Gjyqësore, janë kthyer në materiale procedurale të vlefshme për fillimin e procedimit penal.
- Përsa i përket fenomenit të kultivimit të bimëve narkotike, posedimit të lëndëve narkotike në krahasim me vitin paraardhës ka patur rritje të numrit të veprave penale për këtë rast, më konkretisht në vitin 2019 janë regjistruar 48 procedime penale krahasuar me 44 procedime penale të regjistruara në vitin 2018.

- Nga ana e policisë gjatë vitit 2019, pas hetimeve me veprime proaktive, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Durrës, është arritur të ketë sukses në kapjen e sasive të mëdha të lëndëve narkotike të llojeve të ndryshme dhe të autorëve të këtyre veprave penale. Megjithatë duhet bërë më shumë në drejtim të identifikimit dhe vënies para përgjegjesisë të personave konkretë që mund të jenë organizatorë, financues dhe të përfshirë në këtë veprimtari kriminale. Gjithahstu, pas krijimit të SPAK, kompetenca lëndore e veprave penale në fushën e trafiqeve tashmë i përket prokurorive të rretheve dhe në këtë kuadër është krijuar Seksioni i Trafiqeve dhe hetimit pasuror. Meqënëse hetimi i këtyre veprave penale është një risi për shkallën e parë është i domosdoshëm trajnimi i prokurorëve dhe opgj-ve që do të hetojnë vepra penale të tilla.
- Po ashtu gjatë vitit 2019 janë vërejtur problematika dhe në hetimin e çështjeve të tilla si:
 - Tejkalmimi i afateve në hetimin e veprave penale si dhe cilësia e hetimit si në përpilimin e akteve ashtu dhe në mbledhjen e provave nga ana e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
 - Vonesa në vendimmarrjen e prokurorëve ku shkak ka qenë dhe mosbërja në kohë e akteve të ekspertimit nga ana e Policisë Shkencore dhe ekspertëve të fushave të ndryshme, gjë e cila ka çuar në zvarritjen e afateve të hetimit përtej përcaktimeve ligjore.
 - Cilësi jo mirë e përpilimit të akteve procedurale nga Policia Gjyqësore si e seksionit të Prokurorisë ashtu dhe të shërbimeve pranë Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Durrës, si në referimin jo të saktë të veprës penale, marrjes së provave, gjeneraliteteve të subjekteve, mosnjohimit të prokurorit për ngjarjet e ndodhura etj, veprime të cilat kanë sjellë cilësi të dobët të hetimit dhe zbatimit të ligjit procedural penal duke e vendosur kështu prokurorin në vështirësi në zgjidhjen në kohë të çështjes penale si dhe të kualifikimit të drejtë të veprës penale.
 - Hetimi i dobët ka sjellë dhe dhënien e pafajësive nga ana e gjykatës për disa çështje penale të cilat kanë qenë objekt i diskutimeve dhe të nxjerrjes së konkluzioneve dhe përgjegjësive përkatëse.

II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË

1. VOLUMI I PUNËS NË HETIM

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, gjatë vitit 2019 ka trajtuar në total **5887** materiale hetimore, ndërsa në vitin 2018 janë trajtuar **5195** materiale hetimore, që do të thotë se kemi një rritje me 13.32%, ku gjatë trajtimit të këtyre materialeve është konkluduar dhe më pas është vendosur regjistrimi i procedimeve penale për **2823** procedime, në krahasim me vitin 2018 ku janë regjistruar **2779** procedime. Konstatohet se kemi rritje në masën 1.58% të regjistrimeve për procedimet penale krahasuar me vitin 2018.

Në vitin 2019 është vendosur mosfillimi për **1907** materiale kallëzuese, ndërsa për vitin 2018 janë mosfilluar **1455** materiale kallëzuese. Krahasuar me vitin 2018 rezulton se kemi një rritje prej 31.06% të materialeve hetimore për të cilat trupa e prokurorëve ka vendosur mosfillimin e procedimeve penale.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2019 ka ndjekur në hetim **3980** procedime penale përfshirë dhe ato të mbartura nga viti 2018 dhe **3** procedime penale ushtarake.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, gjatë vitit 2019 në hetimet paraprake ka ndjekur **3983** procedime penale, me **1636** të pandehur, nga të cilët **304** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”. Nga këto, janë regjistruar **2823** procedime penale të reja, me **1063** të pandehur, prej të cilëve **214** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Gjatë vitit **2019** janë regjistruar **76** Procedime Penale të ardhura me transferim, me 22 persona nën hetim dhe **4** të pandehur, nga të cilët me **11** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”. Në krahasim me vitin **2018**, ku janë regjistruar procedime penale të ardhura me transferim për **43** materiale, me **16** persona nën hetim dhe **9** të pandehur me **3** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Në vitin 2019 janë rifilluar **40** procedime penale me **6** të pandehur, në krahasim me vitin 2018 ku janë rifilluar **63** procedime penale, me **6** persona nën hetim dhe **6** të pandehur.


Në vitin 2019 janë përfunduar hetimet për **2455** procedime penale, me **1251** të pandehur me **191** persona të arrestuar, ndërsa për vitin 2018 ky numër procedimesh të përfunduara hetimet është **2689**, me **1451** të pandehur, nga të cilët **210** të arrestuar, që zënë **61.63%** të procedimeve penale të ndjekura ose **8.7%** procedime penale të përfunduara më pak se në vitin 2018.

Janë **mbartur** për vitin 2019 në fazën e hetimeve paraprake **1052** procedime penale (këtu përfshihet 1 procedim penal ushtarak), me **350** të pandehur dhe 219 persona nën hetim, prej të cilëve **91** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”, pra rreth **26.41%** e numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të hetuara gjatë vitit 2019.

Janë mbartur në hetim për vitin **2020**, **1528** procedime penale (këtu përfshihen 3 procedime penale ushtarake), me **113** persona me masë sigurimi “Arrest në burg” dhe **385** persona në hetim, krahasuar me vitin 2018 kemi një rritje prej **45.24%**.

Më poshtë, në tabelë paraqitja krahasuese e viteve 2018-2019 evidenton treguesit e procedimeve penale të ndjekura, përfshi edhe procedimet penale të mbartura nga viti 2018, të regjistruara, të ardhura me transferim dhe të rifilluara në vitin 2019.


Vitet	Proc.Mbartura	Proc.Rregjistruara	Proc.Rifilluara	Proc. Ardhura me Transf.	Proc. Ndjekje Penale
2018	852	2779	63	43	3737
2019	1052	2823	40	76	3991
Krahasimi	Rritur 23.47%	Rritur 1.58%	Ulur 36.5%	Rritur 76.74%	Rritur 6.79%



Evidentohet tendenca në rritje e numrit të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2018.

2. ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË


Gjatë vitit 2019 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është ngritur akuza dhe dërguar për gjykim në emër të shtetit shqiptar për **828** procedime penale, një ulje prej 26.46% në krahasim me vitin 2018, ku janë dërguar për gjykim **828** procedime penale, me **959** të pandehur me **176** të arrestuar, përkundrajt 1156 të pandehurve me **196** të arrestuar në vitin 2018, një ulje prej 17.04% në krahasim me vitin 2018. Këto të dhëna paraqiten grafikisht në grafikun e mëposhtëm:



3. TREGUESIT KRYESOR TË PUNËS SË PROKURORISË

Më poshtë tabela evidenton treguesit e procedimeve penale dhe të pandehurve sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake, krahasuar me vitet 2018-2019.

Vitet	Gjyqit		Pushuara		Pezulluara		Transferuara		Përfunduara	
	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur + Persona nën hetim	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur
2018	1126	1156	439	209	1010	0	113	88	2688	1453
2019	828	959	404	183	1100	0	123	109	2455	1251
Krahasimi	Ulur 24.46%	Ulur 17.04%	Ulur 7.97%	Ulur 12.44%	Rritur 8.91%	Njëlloj	Rritur 8.84%	Rritur 23.86%	Ulur 8.66%	Ulur 13.0%



Sipas mënyrës së përfundimit të hetimeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës rezulton kjo gjendje:

3.1 Çështje të dërguara për gjykim

Krahasuar me vitin 2018 për vitin 2019 konstatohet ulje në masën **24.46%** të procedimeve dhe **17.04%** të pandehurve të dërguar për gjykim. Përkatësisht për vitin 2019 janë dërguar për gjykim **828** procedime penale, ndërsa për vitin 2018 janë dërguar **1126** procedime penale.

3.2 Çështje të pushuara

Janë pushuar **404** procedime penale me **183** persona nën hetim (2 persona me masë sigurimi “njëri prej tyre Arrest në burg në mungesë ndërsa rasti tjetër pushim I pjesshëm I akuzave”) që zënë **16.45%** të procedimeve penale të përfunduara. Në krahasim me vitin 2018, ku janë pushuar **439** çështje penale, me **209** persona nën hetim (me asnjë person me masë sigurimi “Arrest në burg”) vërehet një ulje prej **7.97%**.

Në këtë grup procedimesh, **12** prej këtyre procedimeve penale janë pushuar për mungesë fakti, **29** për mungesë prove dhe **363** për shkaqe të tjera të parashikuara nga K.Pr.Penale.

Nga këto procedime të pushuara, numrin më të madh të vendimit për pushim e zë neni 199/a i K.Penal me **55** pushime për shkaqe të tjera.

Neni 89 i K.Penal është një vepër tjetër, i cili zë një vend të konsiderueshëm në çështjet e pushuara, ku **24** prej tyre janë pushuar kryesisht për shkak të heqjes dorë nga ankimi. Gjithashtu, në lidhje me nenin 291 të K.Penal, kemi **17** procedime penale, për të cilat është marrë vendimi i pushimit, për arsye sepse rezultati i aktit të ekspertimit mjeko-ligjor (të marrjes së mostrës në gjak) ka qenë brenda normave të lejuara.

Një vepër penale tjetër, e cila nuk mund të lihet jashtë vëmendjes së analizës, është edhe neni 290 i K.Penal, ku **33** procedime të regjistruara për këtë vepër janë pushuar për shkak të rezultatit të aktit të ekspertimit autoteknik, sipas të cilit personi përgjegjës për aksidentin ka rezultuar pa shkelje.

Për nenin 275 të K.Penal kemi marrë **23** vendime për pushim, në pjesën më të madhe të tyre për shkak të heqjes dorë nga ankimi.

Në lidhje me nenin 248 të K.Penal, janë marrë **19** vendime për pushim nga ana e prokurorëve, për shkaqe të ndryshme.

Gjithashtu, gjatë këtij viti janë marrë **13** vendime për pushimin e çështjes, në lidhje me nenin 186 të K.Penal, për arsye të mungesës së faktit dhe shkaqe të tjera sipas vlerësimit. Ndërsa nga totali i regjistrimeve për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i K.Penal, janë marrë **8** vendime për pushim nga ana e Prokurorëve.

Si rezultat i punës së përbashkët të prokurorisë me strukturat e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Durrës janë rifilluar hetimet për **40** procedime të pezulluara, me 4 persona, si rezultat i zbulimit të autorit apo të dhënave të tjera të cilat ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve.

Po ashtu rezulton se për vitin 2019 prokurorët kanë paraqitur ne gjykate kërkesë për pushimin e procedimit penal, për **213** procedime penale, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Gjatë vitit 2019, Gjykata e Apelit Durrës ka prishur **4** vendime pushimi të prokurorëve, nga të cilat 2 procedime penale janë pushuar dhe 2 procedime penale janë dërguar për gjykim.

3.3 Çështje penale të pezulluara

Pezullimi i hetimeve është vendosur për **1100** procedime penale, që zënë **44.8%** të procedimeve penale të përfunduara dhe krahasuar me vitin 2018 kemi një rritje me 8.91%, ku janë pezulluar **1010** procedime penale. Të ndarë sipas shkaqeve ligjore për të cilët është vendosur pezullimi gjendja paraqitet:

Për shkak se autori i veprës penale nuk njihet janë pezulluar hetimet dhe vazhdon gjurmimi nga policia për zbulimin e autorëve për **1100** procedime penale.

Numrin më të madh të çështjeve penale për të cilat është marrë vendimi për pezullim e zë neni 134 i K.Penal, me **875** procedime të pezulluara. Gjithashtu, për nenin 141/a të K.Penal, janë marrë **15** vendime për pezullim për moszbulim autori ose në pritje të letërporosisë me autoritetet e huaja. Në lidhje me nenin 143 të K.Penal kemi **15** çështje të pezulluara, ndërsa për nenin 143/b të K. Penal janë marrë **8** vendime për pezullim.

Për çështjet e regjistruara për nenin 151 të K.Penal, janë marrë **22** vendime për pezullim për moszbulim autori, pasi nga akti i ekspertimit piroteknik zjarrvënia është e qëllimshme, por nuk bëhet i mundur identifikimi i autorit të kryerjes së veprës penale.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 190 të K.Penal, janë marrë **3** vendime për pezullimin e çështjes.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 273 të K.Penal, janë marrë **13** vendime për pezullim.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 278 të K.Penal, janë marrë **14** vendime për pezullim, ndërsa për nenin 283 të K.Penal janë pezulluar **8** çështje penale.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 287 të K.Penal janë pezulluar **4** çështje penale, ndërsa për nenin 324/a të K.Penal në totalin e regjistrimeve për vitin 2019, janë pezulluar **7** procedime penale.

3.4 Çështje penale të transferuara

Për vitin 2019 janë transferuar **123** procedime penale, ku krahasuar me vitin 2018 kemi një rritje me 8.84% pasi numri i tyre është **113**. Për sa i përket personave në hetim kemi një rritje prej 23.86%, ku në vitin 2019 janë transferuar çështje penale me 109 persona nën hetim, krahasuar me 88 persona nën hetim të çështjeve të transferuara të vitit 2018.

Me zgjatje afati janë ndjekur **260** procedime, me **336** të pandehur dhe 61 persona me masë sigurimi “Arrest në burg”, që zënë rreth **6.52%** të procedimeve penale të hetuara, krahasuar kjo me një vit më parë kemi një rritje prej 0.4%. Ndërsa për vitin 2018 janë ndjekur 229 procedime penale me zgjatje, me 269 të pandehur me 33 persona me masë sigurimi “Arrest në burg”.

3.5 Mosfillimet

Organi i prokurorisë është organi kompetent që bën regjistrimin e njoftimit/kallëzimit të veprave penale të cilat mund të vijnë nga subjekte të ndryshme fizike dhe juridike.

Kjo nuk do të thotë se në çdo kallëzim të bërë nga subjektet e parashikuara nga nenet 281 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale ekzistojnë elementet e veprës penale. Me qëllim që të evitohen hetimet e panevojshme, ligjvënësi në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar edhe të drejtën e prokurorit që në mungesë të ekzistencës së rrethanave për fillimin e procedimit, të japë vendimin e arsyetuar për mosfillimin e procedimit.

Ky tregues i punës ka pësuar rritje këtë vit në krahasim me vitin e kaluar, pasi rezulton se për vitin 2018 është vendosur mosfillim për **1455** materiale, ndërsa në vitin 2019 është marrë vendimi për mosfillimin e procedimit për **1907** kallëzime apo referime të veprës penale në Prokurori për “Rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit”, nenet 290 e 291 të K.Pr.Penale. Nga këto kallëzime të përfunduara, **34** prej tyre janë materiale verifikuese të mbartura nga viti 2018 dhe **1873** materiale verifikuese të regjistruara në vitin 2019. Në shumë raste për të cilat nuk ka patur elementë të ndonjë vepre penale, prokurorët kanë vendosur regjistrimin e procedimit penal, për shkak të respektimit të afatit 15-ditor brenda të cilit është e pamundur të administrohen aktet e ekspertimit për vepra të tilla, si “Shkaktim vetëvrasje”, neni 99 i Kodit Penal, rastet e përdorimit me ngjashmëri të pasaportave, neni 189 i Kodit Penal, por edhe vepra penale të tjera si ato të parashikuara nga nenet 290, 90, etj. që kanë qenë të qarta për menyrën e përfundimit të tyre.

Krahasuar me vitin 2018 kemi një rritje me **31.06%**. Në rritjen e procedimeve të mosfilluara kanë ndikuar dhe materialet referuese të ardhura nga shërbimet e policisë gjyqësore me sugjerimin për vlerësim.

Në lidhje me çështjet e përfunduara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykata e Apelit Durrës janë prishur **17** vendime mosfillimi të Prokurorëve. Të gjitha këto procedime penale janë në hetim.

Veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak

Në lidhje me veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak për vitin 2019 janë regjistruar 2 procedime penale, me 2 të pandehur, të cilat janë ende në hetim.

4. TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Bazuar në të dhënat e regjistrimit të njoftimeve/kallëzimeve të veprave penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës rezultojnë se në vitin 2019 janë **filluar kryesisht 4** procedime penale nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Kallëzime nga nëpunësit publikë: Në vitin 2019 rezultojnë të jenë 148 kallëzime.

Kallëzime nga IMT (Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit): Në vitin 2019 rezultojnë të jenë 148 kallëzime.

Kallëzime nga shtetasit: Në vitin 2019 rezultojnë 256 kallëzime të bëra nga shtetasit.

Gjithashtu, theksojmë se gjatë vitit 2019 janë marrë **4428** referime nga Policia e Shtetit dhe nga Policia Ushtarake kemi 3 referime.

5. TË DHËNAT NË LIDHJE ME MASAT E SIGURIMIT PERSONAL E PASUROR

Gjatë vitit 2019 janë arrestuar, ndaluar si dhe me urdhër ndalimi të Prokurorit **332** persona, nga të cilët:

- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest në Burg” për **237** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Arrest në Burg” për **197** të pandehur.
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest në Burg” në mungesë për **3** të pandehur, ku edhe Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Arrest në Burg” në mungesë për **3** të pandehur.
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest në Shtëpi” për **1** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Arrest në Shtëpi” **1** të pandehur .
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Burg me Afat” për **2** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Burg me Afat” për **11** të pandehur.
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Garanci Pasurore” për **8** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Garanci Pasurore” për **17** të pandehur.
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Detyrim për paraqitje” për **95** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Detyrim për Paraqitje” për **115** të pandehur.

6. TREGUESIT E EKZEKUTIMEVE TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË

Funksion i organit të prokurorisë është edhe ekzekutimi i vendimeve penale. Për të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë të marra gjatë vitit 2019, organi i prokurorisë ka urdhëruar ekzekutimin e tyre. Më konkretisht gjatë vitit 2019, prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës kanë urdhëruar ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë për **119** të dënuar me burgim dhe për **81** persona me dënim më gjorbë. Nga këto janë ekzekutuar nga policia gjyqësore dhe përmbarimi **700** vendime penale të evidentuar në tabelën e mëposhtme:

Llojet e dënimit	Urdhëruar ekzekutimi	Ekzekutuar	Të mbartura nga viti 2018 pa u ekzekutuar	Ngelen për t'u ekzekutuar
Burg	119	119	333	333
Gjorbë	81	41	503	543
Dënim plotësues	12	0	31	43

Dënime alternative	540	540	1060	1060
Gjithsej 2019	752	700	1927	1979

Së bashku me vendimet e mbartura nga vitet e kaluara ngelen për t'u ekzekutuar dhe **1979** vendime gjyqësore të formës së prerë, nga të cilat **333** me burgim (persona në kërkim) dhe **543** dënime me gjobë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës i ka kushtuar një vëmendje problemit të ekzekutimit të vendimeve penale gjyqësore të formës së prerë, duke zbatuar dispozitat dhe kërkesat ligjore të K.Pr.Penale dhe ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Në të gjitha rastet prokurori i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë ka nxjerrë urdhrat e ekzekutimit pasi i janë vënë në dispozicion vendimet penale të formës së prerë nga gjykata. Nisur nga ndryshimet e Kodit Penal dhe konkretisht për nenin 59 të K.Penal nga ana e prokurorëve janë nxjerrë urdhrat për ekzekutim të menjëhershëm të cilat janë dërguar për zbatim pranë zyrës vendore të shërbimit të provës. Urdhrat e ekzekutimit janë nxjerrë brenda afateve ligjore dhe u janë dërguar për zbatim organeve të Policisë për masat sigurimit, I.E.V.Penale për dënimet me burgim dhe Zyrës Përmbarimore për dënimet me gjobë.

Krahas ekzekutimit të vendimeve penale të gjykatës prokurorët kanë marrë pjesë në gjykimin e kërkesave të veçanta të të dënuarve, për aplikimin e lirit me kusht, qëndrim në shtëpi dhe lirit për shkak sëmundje. Gjatë vitit 2019 janë shqyrtuar gjithsej **163** kërkesa, kryesisht nga të dënuarit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës. Kërkesat e të dënuarve kanë qenë: **27** kërkesa për aplikimin e nenit 64 të K.Penal, nga të cilat **13** kërkesa janë pranuar, **4** janë pushuar dhe **10** janë rrëzuar. **12** kërkesa për aplikimin e nenit 59/a të K.Penal, prej të cilave **3** është pranuar, **7** është pushuar dhe **2** rrëzuar. Janë shqyrtuar **3** çështje për rivendosje në afat, të cilat janë pranuar. Nga çështjet direkte të shqyrtuara, të cilat janë **17** në total, **6** të pranuar, **2** të rrëzuara dhe **8** të pushuara. Kërkesa për amnisti janë **2**, nga të cilat është pushuar **1** dhe **1** kërkesë është transferuar. Kërkesa për shtyrje ekzekutimesh janë regjistruar **3**, të cilat janë pranuar. Këto të dhëna janë pasqyruar më poshtë:

	Kërkesa	Pranuar	Pushuar	Rrëzuar	Transferuar
Çështje direkte	17	6	8	2	0
Rivendosje në afat	3	3	0	0	0
Shtyrje ekzekutimesh	3	3	0	0	0
Shuarje dënimi	11	8	0	3	0
Parashkrim	2	0	2	0	0
Masë mjekësore	3	2	0	0	0
Kujdestari	4	4	0	0	0
N. 59/a K.Penal	12	3	7	2	0
Amnisti	2	0	1	0	1
Lirim para kohe me kusht	27	13	4	10	0
Heqje zotësie	36	28	6	1	0
Shuarje ekzekutimi	11	6	0	1	3
Bashkim dënimesh	6	4	1	0	1
Të tjera (shpall.zhduk/vdekur; rishikim vendimi etj.)	6	5	0	0	0
Llogaritje	8	1	2	5	0

paraburgimi					
Plotësim vendimi	3	0	2	1	0
Të tjera	9	4	2	2	1
Totali	163	90	35	27	6

Në periudhën analizuese janë përfunduar 158 kërkesa dhe 5 kërkesa janë mbartur për vitin 2020.

Për rritjen e efektivitetit të punës lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale është forcuar bashkëpunimi me organet e policisë, veçanërisht për personat e dënuar të shpallur në kërkim, ku çdo muaj analizohet ky problem duke rakorduar dhe pasqyruar në vazhdimësi ndryshimet e listës së personave në kërkim. Megjithë përmirësimet e bëra dhe të evidentuara përsëri vazhdon që të ketë vendime gjyqësore penale të formës së prerë të paekzekutuara.

Mbikqyrja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në veçanti për vënien në ekzekutim të dënimeve me burgim si dhe respektimi i të drejtave të të dënuarve gjatë vuajtjes së dënimit me burgim mbetet një ndër drejtimit e punës tonë me synim riedukimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e të dënuarve në shoqëri, duke bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën tonë me atë të Z.V.Sh.Provës. Në këtë drejtim mendoj se duhet të punohet për arritjen e një politike dënimi e cila duke marrë parasysh gjendjen e kriminalitetit në rrethin e Durrësit dhe specifikat psiko-sociale të shoqërisë, të mbështetet në parimin që nëpërmjet dënimeve gjyqësore të arrihet goditja e krimit dhe jo e shoqërisë.

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 është 2%, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 1%. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

TRAFIKIMI	2018					2019				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 110/a Trafikim i Personave	0	0	0	0	0	4	0	1	0	0
Neni 128/b Trafikimi i të miturve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 138/a Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike	26	0	1	0	0	29	1	0	3	0
Neni 278/a Trafikimi i armëve dhe i municionit	0	0	0	0	0	4	0	2	0	0
Neni 282/a Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve	2	0	1	0	0	22	0	4	0	0
Totali	29	0	2	0	0	59	1	7	3	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 numri i procedimeve të regjistruara është 29, ndërkohë që në vitin 2019 numri i tyre është 59, duke sjellë një rritje në masën 103.44%. Numri i procedimeve të dërguara për gjykim është 0 në vitin 2018, ndërsa në vitin 2019 ky numër është 1, duke sjellë një rritje me 100%. Në lidhje me të pandehurit e regjistruar për këtë grup veprash penale në vitin 2018 numri i tyre është 2, ndërkohë që në vitin 2019 numri i tyre është 7, duke sjellë një rritje në masën 250%. Sa i përket të pandehurve të dërguar për gjykim numri i tyre në vitin 2018 është 0, ndërsa në vitin 2019 është 3, duke sjellë një rritje me 100%. Në vitin 2018 numri i të pandehurve të dënuar është 0, po aq sa në vitin 2019.

PRODHIMI DHE KULTIVIMI I NARKOTIKËVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 është 1.7%, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 1.58%. Vihet re një rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

PRODHIMI DHE KULTIVIMI I NARKOTIKËVE	2018					2019				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve	41	18	27	28	28	42	21	26	29	13
Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike	3	1	5	1	1	6	1	3	2	0
Neni 284/a Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 285 Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	44	19	32	29	29	48	22	29	31	13

Siç vërehet edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 numri i procedimeve të regjistruara është 44, ndërkohë që në vitin 2019 numri i tyre është 48, duke sjellë një rritje në masën 9.09%. Në vitin 2018 numri i procedimeve të dërguara për gjykim është 19, ndërkohë që në vitin 2019 numri i tyre është 22, duke sjellë një rritje në masën 15.78%. Numri i të pandehurve të regjistruar në vitin 2018 është 32, ndërkohë që në vitin 2019 numri i tyre është 29, duke sjellë një rënie në masën 9.37%. Në vitin 2018 numri i të pandehurve të dërguar për gjykim është 29, ndërkohë në vitin 2019 numri i tyre është 31, duke sjellë një rritje në masën 6.89%. Gjithashtu në vitin 2018 numri i të pandehurve të dënuar është 29, ndërkohë që në vitin 2019 numri i tyre është 13, duke sjellë një rënie në masën 55.17%.

V.O. Procedimet e dërguara për gjykim janë edhe procedimet e mbartura.

IV. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË


1. TREGUESIT E EFEKTIVITETIT NË GJYKIM DHE NË DËNIMIN E TË PANDEHURVE

Një pjesë të konsiderueshme të ngarkesës së punës së secilit prokuror zë edhe pjesëmarrja në gjykim, të cilën e kemi analizuar si një tregues të veçantë të punës së secilit prokuror. Vihet re, një tregues në rritje i cilësisë në ushtrimin e ndjekjes penale, si dhe një numër i lartë i dërgimit të çështjeve në gjykim. Kështu rezulton se gjatë këtij viti prokurorët kanë përfunduar gjykimin e këtyre çështjeve penale.

Gjatë vitit 2019, prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës kanë përfaqësuar akuzën në gjykimet penale të **511** çështjeve, në ngarkim të **563** të pandehurve, prej të cilëve **87** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Krahasuar me një vit më parë kemi një ulje të procedimeve penale në masën 34.58% të të pandehurve ndaj të cilëve është përfaqësuar akuza në gjykatë, sipas tabelës së mëposhtme:

Vitet	Gjykuar		
	Procedime	Pandehur	Arrestuar
2019	511	563	87
2018	483	536	133
Krahasimi	Rritur 5.79%	Rritur 4.79%	Ulur 34.58%



2. TË DHËNA PËR GJYKIMET E POSAÇME

Analiza e treguesve sipas llojeve të gjykimin të ekspozuara në tabelën e mëposhtme evidenton se:

Për **84.69%** të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi i shkurtuar, konkretisht për 476 çështje të gjykuara në vitin 2019 krahasuar me 451 çështje të gjykuara në vitin 2018, ose 5.54% më shumë se në vitin 2018.

Për **1.92%** të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi i zakonshëm, konkretisht për 11 çështje të gjykuara në vitin 2019 krahasuar me 12 çështje të gjykuara në vitin 2018, ose 50% më pak se në vitin 2018.


Për **3.91%** të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi i drejtpërdrejtë, konkretisht për 22 çështje të gjykuara në vitin 2019 krahasuar me 33 çështje të gjykuara në vitin 2018, ose 33.33% më pak se në vitin 2018.

Për **7.11%** të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi me marrëveshje për pranimin e fajësisë, konkretisht për 40 çështje të gjykuara në vitin 2019 krahasuar me 99 çështje të gjykuara në vitin 2018, ose 59.59% më pak se në vitin 2018.

Për **2.13%** të çështjeve të gjykuara është aplikuar miratimi i urdhrit penal, konkretisht për 12 çështje të shqyrtuara në vitin 2019 krahasuar me 33 çështje të shqyrtuara në vitin 2018, ose 63.63% më pak se në vitin 2018.

Në vitin 2019 është aplikuar 1 çështje gjykim në mungesë, krahasuar me 0 çështje të gjykuara në vitin 2018, ose 100% më shumë se në vitin 2018.

Vitet	Llojet e Gjyimit					
	Drejtpërdrejtë	Zakonshëm	Shkurtuar	Në Mungesë	Urdhër Penal	Marrëveshje fajësie
2018	33	12	451	0	33	99
2019	22	11	476	1	12	40
Krahasimi	Ulur 33.33%	Ulur 50%	Rritur 5.54%	Rritur 100%	Ulur 63.63%	Ulur 59.59%



Në gjykimin e këtyre çështjeve prokurorët kanë kërkuar krahas deklarimit fajtor, dënimin e të pandehurve me lloje dënimi si: **55** persona **me gjobë** dhe **190** persona **me burgim**. Kërkesat për dënimin me burgim zënë 77.55% të kërkesave të prokurorëve. Gjithashtu këtë vit prokurorët kanë kërkuar pushimin e akuzës dhe pushimin e çështjes në gjykim për **35** çështje penale.

Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, mbi këto kërkesa ka vendosur për deklarimin fajtor me Gjobë për **56** persona, dënim me burg **156** të pandehur, dënim në lidhje me nenin 59 të K.Penal janë **337** të pandehur, pushim çështje dhe akuze për **34** çështje penale, pafajësi për **14** të pandehur.

Të dhëna në lidhje me seancat e gjykimeve paraprake

Me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale, me Ligjin nr. 35/2017 datë 05.05.2017, hyrë në fuqi më datë 01.08.2017 tashmë ka ndryshuar roli i Prokurorit në hetim dhe gjykim. Prokurori nuk është më në rolin e vendimmarrësit në rastet e gjykimit të çështjeve dhe të pushimit të tyre për veprat penale që përbëjnë krime, por në rolin e kërkuesit.

Si pasojë e këtyre ndryshimeve ligjore ka patur problematika të shumta në lidhje me vlerësimin e kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim apo të kërkesave për pushimin e çështjeve gjatë seancës paraprake. Rezulton se ka patur raste të kthimit të dosjeve për plotësim si të atyre të dërguara për gjykim ashtu dhe për pushim.

Në zbatim të dispozitave procedurale penale nga ana jonë janë analizuar rastet, rast pas rasti, duke kryer veprimet hetimore kur vendimi i gjykatës ka qenë i arsyetuar, por duke bërë dhe ankim ndaj vendimeve gjyqësore në rastet kur në vlerësimin tonë vendimet kanë qenë të padrejta dhe të pambështetura në ligj.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, mbi bazën e ndryshimeve të K.Pr.Penale, janë dërguar kërkesa për pushim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për 227 çështje, nga të cilat janë shqyrtuar 101 kërkesa, prej tyre janë kthyer aktet për **10** raste, konkretisht si më poshtë:

- 1.Prokurore Suela Beluli, kërkesë për pushim për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i K.Penal.
- 2.Prokuror Gëzim Veizi, kërkesë për pushim për veprën penale të parashikuar nga neni 143/3 i K.Penal.
- 3.Prokuror Drini Pali, kërkesë për pushim për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal.
- 4.Prokurore Suela Beluli, kërkesë për pushim për veprën penale të parashikuar nga neni 248 e 186/1 i K.Penal.
- 5.Prokurore Enkeleda Xhengo, kërkesë për pushim për veprën penale të parashikuar nga neni 248, 199/a i K.Penal.
- 6.Prokuror Ndrëçim Troplini, kërkesë për pushim për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal.
- 7.Prokuror Arben Sharra, kërkesë për pushim për veprën penale të parashikuar nga neni 290/2 i K.penal.
- 8.Prokuror Sokol Nishnai, kërkesë për pushim për veprën penale të parashikuar nga neni 290/2 i K.Penal.
- 9.Prokurore Oltiana Çifliku, kërkesë për pushim për veprën penale të parashikuar nga neni 290/3 i.K.Penal.
- 10.Prokuror Drini Pali, kërkesë për pushim për veprën penale të parashikuar nga neni 305 i K.Penal.

Të gjitha këto vendime gjyqësore për kthim aktesh nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, janë ankimuar nga ana e Prokurorëve, ku për 2 raste është vendosur prishja e vendimit dhe miratimi i Kërkesës së Prokurorit.

Për sa i përket çështjeve të dërguara për gjykim, janë dërguar **828** kërkesa dhe miratuar pjesa më e madhe e tyre. Gjatë seancave paraprake, është pushuar çështja nga Gjykata e Rrethit për **8** raste, pjesa më e madhe e të cilave janë ankimuar nga ana e prokurorëve.

Konkretisht, nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës janë pushuar gjatë seancës paraprake çështjet e dërguara për gjykim, sipas listës më poshtë:

1. Prokuror Bledar Bejko, neni 89 i K.Penal, neni 236/2 të dërguara për gjykim. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur pushimi i çështjeve. (2 raste)
2. Prokuror Sokol Nishani, neni 137 i K.Penal, e dërguar për gjykim. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur pushimi i çështjes.
3. Prokuror Drini Pali, neni 199/a-2 i K.Penal, neni 305/b, të dërguara për gjykim. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur pushimi i çështjeve. (2 raste)
4. Prokurore Enkelda Xhengo, neni 247 i K.Penal, e dërguar për gjykim. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur pushimi i çështjes.
5. Prokurore Flora Reka, neni 277 i K.Penal, e dërguar për gjykim. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur pushimi i çështjes.
6. Prokuror Arben Sharra, neni 290/1 I K.Penal, e dërguar për gjykim. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur pushimi i çështjes.

Gjithashtu, në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim, gjatë seancës paraprake, janë kthyer aktet nga Gjykata e Rrethit për **7** raste, si më poshtë:

1. Prokurore Oltiana Çifliku, për nenin 199/a të K.Penal dhe një rast për neni 124 të K.Penal. Janë kthyer aktet me afat, çështja është dërguar përsëri për gjykim.
2. Prokuror Bledar Bejko, për nenin 291 (kërkesë për gjykim të drejtëpërdrejtë), nuk është pranuar kërkesa për gjykim të drejtëpërdrejtë, çështja është dërguar për gjykim me kërkesë të thjeshtë.
3. Prokuror Drini Pali, për nenin 290 e 291 të K.Penal. Janë kthyer aktet me afat, çështja është dërguar përsëri për gjykim.
4. Prokuror Edmond Koloshi, për nenin 186 të K.Penal. Janë kthyer aktet me afat, çështja është dërguar përsëri për gjykim.
5. Prokuror Gëzim Veizi, për nenin 89 e 150 të K.Penal. Janë kthyer aktet me afat, çështja është dërguar përsëri për gjykim.
6. Prokuror Pali Deçolli, për nenin 277 të K.Penal. Janë kthyer aktet me afat, çështja është dërguar përsëri për gjykim.
7. Prokurore Teuta Rrudha, për nenin 189 të K.Penal. Janë kthyer aktet me afat, çështja është dërguar përsëri për gjykim.

Përsa i përket çështjeve të dërguara me kërkesë për miratim marrëveshje fajësie, në **40** kërkesa, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur kthimin e akteve për **3** prej tyre:

1. Prokurore Edina Kurti, për dy raste për nenin 291, të cilat janë dërguar me kërkesë për gjykim dhe janë pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Prokurore Teuta Rrudha, për nenin 199/a-1, e cila është dërguar me kërkesë për gjykim dhe është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.


Përsa i përket çështjeve të dërguara me kërkesë për miratim urdhri penal, në **12** kërkesa, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur kthimin e akteve për **2** prej tyre:

1. Prokuror Drini Pali, çështje për nenin 297 të K.Penal dhe për nenin 89 të K.Penal, të cilat janë dërguar me kërkesë për gjykim dhe janë pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

3.TË DHËNAT MBI LLOJET DHE MASAT E DËNIMEVE

Kërkesa e prokurëve dhe vendimet e gjykatës për llojin dhe masën e dënimit për të pandehurit paraqitet sipas tabelës (të dhënat janë në përputhje me regjistrat e gjykatës).

Lloji i kërkesës	2018		2019		Krahasimi	
	Kërkesa e Prokurorit	Vendime Gjykatës	Kërkesa e Prokurorit	Vendime Gjykatës	Kërkesa e Prokurorit	Vendime Gjykatës
Gjobë	58	57	55	56	Ulur 5.17%	Ulur 1.75%
Burgim	211	190	190	156	Ulur 9.95%	Ulur 17.89%
Neni 59	273	283	316	337	Rritur 15.75%	Rritur 19.08%
T/Akteve	1	0	0	0	Ulur 100%	Njëlloj
Pushuar	9	16	35	34	Rritur 288.88%	Rritur 112.5%
Pafajësi	0	12	0	14	Njëlloj	Rritur 1.66%
Përjashtim nga dënimi	0	0	0	0	Njëlloj	Njëlloj



TË DHËNA PËR PAFAJSTITË E VENDOSURA NGA GJYKATA NË VITIN 2019**Prokurori Afrim Shehu**

1. Për nenin 145 të K.Penal, ka kërkuar deklarinimin fajtor dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal për një të pandehur, ndërsa Gjykata ka vendosur pafajësi.
Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2019-640 date 10.04.2019 ka vendosur “Prishjen e Vendimit penal Nr. (11-2019-849) 33, datë 12.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kthimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për rigjykim me tjetër trup gjykues.

Prokurori Bledar Bejko

1. Për nenin 186/1 të K.Penal, ka kërkuar deklarinimin fajtor dhe dënimin me burgim për dy të pandehur, ndërsa Gjykata ka vendosur pafajësi.
2. Për nenin 174/2 të K.Penal, ka kërkuar deklarinimin fajtor dhe dënimin me burgim për dy të pandehur, ndërsa Gjykata ka vendosur pafajësi.
3. Për nenin 186 të K.Penal, kërkuar deklarinimin fajtor të subjektit juridik, ndërsa Gjykata ka vendosur pafajësi.

Prokurori Ndrichim Troplini

1. Për nenin 248 të K.Penal, ka kërkuar deklarinimin fajtor dhe dënimin me burgim dhe aplikimin e nenit 59 për një të pandehur, ndërsa Gjykata ka vendosur pafajësi.
2. Për nenin 186/1 të K.Penal, kërkuar delarinimin fajtor dhe dënimin me burgim dhe aplikimin e nenit 59 për një të pandehur, ndërsa Gjykata ka vendosur pafajësi.

Prokurore Flora Reka

1. Për nenin 130/a/1 dhe 89-25 të K.Penal, ka kërkuar deklarinimin fajtor dhe dënimin me burgim dhe aplikimin e nenit 58 të K.Penal për dy të pandehur, ndërsa Gjykata ka vendosur pafajësi.
2. Për nenin 186/1 të K.Penal, ka kërkuar deklarinimin fajtor dhe dënimin me burgim për një të pandehur, ndërsa Gjykata ka vendosur pafajësi.

Prokurore Enkeleda Xhengo

1. Për nenin 130/a/1 të K.Penal, ka kërkuar deklarinimin fajtor dhe dënimin me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal për një të pandehur, ndërsa Gjykata ka vendosur pafajësi.

Prokurore Oltiana Cifliku

1. Për nenin 199/a/2 të K.Penal, ka kërkuar deklarinimin fajtor dhe dënimin me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal për një të pandehur, ndërsa Gjykata ka vendosur pafajësi.

Prokurori Pali Deçolli

1. Për nenin 237-25 të K.Penal, ka kërkuar deklarinimin fajtor dhe dënimin me burgim të K.Penal për një të pandehur, ndërsa Gjykata ka vendosur pafajësi.

Vendimet e pafajësive të dhëna nga Gjykata në 11 çështje me 14 të pandehur janë ankimuar nga ana e Prokurorëve, por vetëm për njërin rast Gjykata e Apelit ka shqyrtuar çështjen, ndërsa rastet e tjera ende nuk janë shqyrtuar në apel.

Në analizë të këtyre treguesve, krahas evidentimit të problematikave konkrete rast pas rasti jemi fokusuar gjithnjë e më shumë në përmirësimin e punës tonë në ushtrimin e funksioneve si më poshtë:

Së pari, prokurorët janë udhëzuar që të përdorin më gjerësisht teknikat e veçanta të hetimit në kërkimin dhe administrimin e provave siç janë përgjimet, vëzhgimet, agjentin e infiltruar

dhe ekzaminime të tjera shkencore të provave objektive, veçanërisht për krime të rënda që janë në kompetencë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë.


Së dyti, për të zgjedhur dhe kërkuar në gjykatë masa sa më të përshtatshme të sigurimit personal, duke patur si synim që masa e sigurimit “arrest në burg” të aplikohet vetëm për krime të rënda dhe në ato raste kur masa alternative nuk është e përshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veprës penale dhe të pandehurit.

Së treti, jemi munduar dhe kemi patur gjithmonë në vëmendjen tonë shmangien e ashpërsimit të panevojshëm të kërkesave për lloje dhe masa dënimi, duke përshtatur më mirë kërkesat për dënime në përputhje me një politikë penale sa më të drejtë, me synim aplikimin e dënimeve alternative për kundravajtjet penale dhe veprat penale me rrezikshmëri të vogël shoqërore. Këtë vit janë shtuar kërkesat për miratimin e marrëveshjeve krahasuar me një vit më parë. Megjithatë mbetet më shumë për t’u bërë në këtë drejtim, pasi nga disa prokurorë nuk janë aplikuar pothuajse fare këto forma të gjykimeve të posaçme.


Së katërti, jemi orientuar drejt qëndrimeve të unifikuara në kërkesat për llojin dhe masën e dënimit, veçanërisht për vepra penale të kryera më shpesh në rrethin e Durrësit, me qëllim për të shmangur shkeljen e barazisë para ligjit.

4. TË DHËNA SOCIALE DHE DEMOGRAFIKE PËR TË PANDEHURIT


Nga të dhënat statistikore rezulton se raporti i të pandehurve meshkuj-femra (1547 meshkuj dhe 89 femra) në vitin 2019 ka qenë 94.55% me 5.45%. Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme:




Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2019 rezultojnë 41.8% e të pandehurve me arsim deri 9-vjeçar (684), me arsim të mesëm (810) rezultojnë 49.51%, ndërsa me arsim të lartë (142) rezultojnë 8.69% e të pandehurve.



Përsa i takon gjendjes shoqërore të të pandehurve, rezulton se në vitin vitin 2019 të punësuar në sektorin shtetëror (101) rezultojnë 6.17% e të pandehurve, në sektorin privat (494) rezultojnë të punësuar 30.19% dhe të papunë (1041) rezultojnë 63.64%.




Sikurse rezulton edhe nga tabela e mëposhtme, në lidhje me vendbanimin e personave të cilët janë marrë të pandehur, theksojmë se nga të dhënat statistikore rezulton se kriminaliteti mbetet një fenomen i pranishëm më shumë në qytet sesa në fshat, ndërkohë që për vitin 2019 në qytet (970) banojnë 59.29% e të pandehurve, ndërsa në komunë (666) janë 40.71% e të pandehurve.



5.TË DHËNAT PËR PASOJAT E VEPRAVE PENALE

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me pasojat në dëm të jetës e shëndetit të regjistruara në vitin e fundit:



Peshën më të madhe të pasojave zë plagosja e lehtë me 46 persona (37.7%). Duke vijuar më tej me plagosjen e rëndë me 34 persona (27.86%) dhe duke përfunduar me vdekjen me 42 persona (34.44%).

V. TË DHËNAT LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

Prokurorët e Seksionit të hetimit për të miturit dhe Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, krijuar në bazë dhe për zbatim të Ligjit **Nr. 97/2016**, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe të Urdhrit **Nr. 03**, datë **06.02.2017**, të përditësuar me urdhra riorganizimi në vitin 2018, shtuar një prokuror në këtë seksion, përgjatë vitit 2019 janë përpjekur dhe kanë përballuar një volum të konsiderueshëm pune në drejtim të ushtrimit të veprimtarisë së tyre ligjore dhe procedurale me ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Apelit Durrës si dhe me kryerjen e mjaft procedurave të tjera ligjore, objekt i punës dhe i veprimtarisë ligjore të këtij seksioni.

Njëkohësisht veç sa më sipër tregues të qartë dhe konkret të një volumi të konsiderueshëm pune të Prokurorëve të këtij seksioni kanë qenë dhe mbeten, kryerja në kohë dhe brenda afateve ligjore të procedurave që kanë të bëjnë me ekstradimet e personave, autorë të kryerjes së veprave të ndryshme penale, të cilët janë dënuar me burgim, me vendime të formës së prerë nga Gjykata, apo dhe autorë të këtyre veprave penale për të cilët është caktuar masë sigurimi, “Arrest në burg”.

Kështu përgjatë vitit 2019 nga seksioni i ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është kërkuar pranë kësaj Gjykate për **21** raste ekstradimi për jashtë vendit tonë i personave që janë dënuar me vendime të formës së prerë nga gjykatat e huaja apo për shkak të masave të sigurimit “Arrest në burg” që janë caktuar ndaj tyre nga po këto Gjykata.

Ndërsa përsa i përket procedurave ligjore të ekstradimit nga jashtë vendit tonë i personave që janë dënuar me vendime të formës së prerë nga Gjykata e Rrethit Durrës dhe ajo e Apelit Durrës apo për shkak të masave të sigurimit “Arrest në burg” të caktuara nga po këto Gjykata, përgjatë vitit 2019 nuk është regjistruar asnjë e tillë.

Njëkohësisht përgjatë vitit 2019 nga seksioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë kryer të gjitha procedurat e duhura ligjore në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës për **“Njohjen e Vendimit Penal të Huaj”** të cilat janë gjithsej në **4** raste konkrete.

Njëkohësisht veç sa më sipër tregues të qartë dhe konkret të volumit të punës së Prokurorëve të këtij seksioni kanë qenë dhe mbeten, kryerja në kohë dhe brenda afateve ligjore të procedurave që kanë të bëjnë me ekzekutimin e letër-porosive të ndryshme si për ato të ardhura nga jashtë vendit tonë në adresë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ashtu dhe për ato letër-porosi që janë dërguar nga këto dy institucione jashtë vendit tonë.

Konkretisht përgjatë vitit 2019 nga seksioni i ekzekutimit të vendimeve penale Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë dërguar për ekzekutim për jashtë vendit tonë **76** letër-porosi, ndërsa nga jashtë vendit tonë për llogari ekzekutimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës kanë ardhur dhe janë ekzekutuar **47** letër-porosi.

Njëkohësisht përgjatë vitit 2019 nga seksioni i ekzekutimit të vendimeve penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë përpiluar dhe dërguar për ekzekutim **43** Vendime “Për shpalljen në kërkim ndërkombëtar” të cilat janë lëshuar në adresë të personave të dokumentuar si autorë të veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Përsa i përket transferimeve të personave të dënuar gjatë vitit 2019 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës nuk janë kryer transferime nga jashtë dhe për jashtë.


Në lidhje me shpalljen e personave në kërkim ndërkombëtar rezulton që gjatë vitit 2018 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë shpallur në kërkim 43 persona, ndërkohë që janë hequr nga kërkimi ndërkombëtar **5** persona.

VI. TË DHËNAT PËR NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR DHE OFICER TË POLICISË GJYQËSORE

NGARKESA E PUNËS SË PROKURORËVE GJATË VITIT 2019

Gjatë vitit 2019, nga ana e Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është përballuar një ngarkesë pune e konsiderueshme e çështjeve penale dhe gjykimeve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ashtu siç edhe e kemi trajtuar në pikën e parë të këtij raporti (Analize), rezulton se nga prokurorët është hetuar një numër më i madh çështjesh penale se ato të regjistruara gjatë gjithë vitit 2018. Më konkretisht po japim në një tabelë përmbledhëse të dhënat e ngarkesës së secilit prokuror dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve prej tyre.

Nr.	Prokurori	Totali	Mosfilluar	Pushuar	Gjykatës	Pezulluar	Transferuar	Në hetim
1.	E.Xhengo	193	89	44	50	86	13	89
2.	G.Veizi	185	131	30	47	96	12	41
3.	B.Bejko	181	105	32	66	71	12	112
4.	S.Nishani	177	99	18	46	106	7	99
5.	T.Rrudha	165	111	19	69	70	7	96
6.	D.Pali	162	122	30	54	68	10	83
7.	A.Ndoja	154	98	41	27	86	0	0
8.	M.Kullolli	150	119	14	46	86	4	93
9.	A.Sharra	149	117	22	51	67	9	97
10.	R.Halili	126	119	9	42	70	5	90
11.	P.Deçolli	121	98	7	39	56	4	121
12.	F.Reka	104	151	4	40	58	2	72
13.	A.Allajbeu	95	55	14	43	30	8	0
14.	O.Çifliku	87	55	15	49	18	5	36
15.	E.Kurti	82	110	6	23	53	0	0
16.	A. Bebeçi	70	58	17	34	18	1	29
17.	A.Shehu	69	37	21	27	14	7	98
18.	E.Koloshi	48	20	16	19	11	2	59
19.	I.Turja	46	86	13	25	6	2	65
20.	N.Troplini	34	50	15	12	3	4	120
21.	S.Beluli	29	20	12	9	7	1	20
22.	P.Gruda	14	18	1	2	9	2	36
23.	A.Gjana	14	19	2	5	4	3	50
24.	E.Pelushi	7	19	1	2	1	3	61
25.	A.Felaj	6	1	1	1	4	0	4
26.	A.Jella	2	0	0	0	2	0	0




NGARKESA E PUNËS SË OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE GJATË VITIT 2019

Përsa i përket ngarkesës së punës së Oficerëve të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2018 ajo paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Oficeri i Policisë Gjyqësore	Seksioni	Nr.çështjeve trajtuar për vitin 2019	Statusi					
				Dërguar gjyqit	Pushuar	Mosfilluar	Pezulluar	Mbartur 2020	Tjetër
1	A.Gashi	Sek.Përgjithshëm	105	41	14	-	14	36	-
2	A.Lila	Sek.Përgjithshëm (Opgj i Shërbimeve)	201	65	32	-	28	53	3
3	A.Shehu	Sek.Përgjithshëm	137	39	23	7	30	50	6
4	A.Basha	Sek. Përgjithshëm	208	75	24	-	40	69	-
5	G.Gashi	Sek.Përgjithshëm	157	41	16	-	60	38	2
6	K.Gjoni	Sek.Përgjithshëm (Opgj i Shërbimeve)	102	25	19	-	33	24	1
7	K.Braho	Sek.Përgjithshëm	8	4	-	-	2	2	-
8	Gj.Prifti	Sek.Ekonomik	68	11	13	5	2	36	1
9	B.Dollaku	Sek.Ekonomik	40	3	9	-	2	26	-
10	O.Manushi	Sek.Ekonomik	30	4	2	-	-	21	3
11	E.Xhetani	Sek.Ekonomik	106	31	4	17	5	47	2
12	K.Dyrmishi	Sek. për Trafiket dhe Hetimin Pasuror	58	9	11	3	4	34	-
13	E.Çaku	Sek. për Trafiket dhe Hetimin Pasuror	22	-	-	1	-	21	-
14	I.Ndrea	Sek. për Trafiket dhe Hetimin Pasuror	71	11	1	-	17	42	-
15	A.Mataj	Sek. për të miturit	111	42	17	22	13	33	31
16	L.Ndreu	Sek. për të miturit	46	15	8	-	8	15	-
17	A.Vogli	Sek. për të miturit	90	21	12	20	10	57	-

Grafiku i mëposhtëm paraqet ngarkesën e punës të Oficerëve të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2019:



VII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

Lidhur me administrimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është për t'u theksuar fakti se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në bazë të strukturës së dërguar nga ana e Sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme ka patur në organikën e saj një trupë prej 26 prokurorësh, ku përfshihen një Drejtues, një Zëvendës Drejtues, dhe njëzetë e katër prokurorë sektori. Po kështu dhe 13 oficerë të policisë gjyqësore.

Mungesat e prokurorëve për shkaqet që arsyetuar më lart, kanë ndikuar dukshëm në mbartjen e një numri më të lartë procedimesh penale në krahasim me vitin 2018 krahas faktorëve të tjerë objektivë dhe subjektivë që kanë ndikuar në situatën aktuale. Në këtë kontekst çmujmë se duke marrë në konsideratë ngarkesën në rritje nga viti në vit të procedimeve penale dhe të materialeve kallëzuese, por dhe natyrën e tyre është e nevojshme të shtohet numri i prokurorëve. Po kështu duke analizuar dhe sfidat e kohës ku gjithmonë e më shumë po vihet theksi dhe kërkohet një angazhim sa më i madh i Prokurorëve në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe atij ekonomik-financiar, kundër krimit të organizuar, dhe një sërë veprash penale të një karakteri të rëndësishëm në veçanti vlerësojmë se për përballimin e këtyre sfidave duhet një numër më i madh prokurorësh efektivë në punë për t'iu përgjigjur kërkesave të kohës. Kjo për shkak se jemi të ndërgjegjshëm se volumi i tepërt në punë ndikon dhe në cilësinë e saj.

Në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, janë organizuar seksione për kategori të caktuara veprash penale, në përbërje të të cilëve janë caktuar jo më pak se tre prokurorë. Kështu janë krijuar dhe kanë ushtruar veprimtarinë e tyre Seksioni për hetimin e veprave penale me persona të mitur, për Ekzekutimin e e Vendimeve penale të formës së prerë. Ky seksion ka mbuluar në veprimtarinë e tij dhe kërkesat në fushën e marrëdhënieve juridikionale me jashtë. Po kështu janë krijuar dhe dy seksione të tjera, Seksioni për hetimin e krimit Ekonomik, Financiar dhe Kibernetik si dhe Seksioni për hetimin e krimeve të përgjithshme. Për secilin nga tre seksionet në zbatim të nenit 21/2 të ligjit 97/2016 janë caktuar shefat e seksionit, si dhe nga këta ta fundit nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është caktuar dhe Zëvendës Drejtuesi i Prokurorisë. Me krijimin e SPAK-ut dhe kalimin e një numri të madh procedimesh dhe hetimesh pasurore, është krijuar seksioni i Trafiqueve dhe Hetimit Pasuror.

Disa herë puna e Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore mbi bazën e kërkesës për informacion të Drejtuesit të Prokurorisë apo të drejtuesve të seksioneve ka qenë objekt i verifikimeve lidhur me çështje konkrete dhe sidomos për ato në kalim të afateve të hetimit të tyre duke lënë për çështje konkrete dhe udhëzime të karakterit jo të detyrueshëm sikurse përcakton ligji 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" në nenin 48 të tij.

Çdo prokuror në punën për hetimin e çështjeve penale është ndihmuar nga të paktën dy Oficerë të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Durrës sipas ndarjes së caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka organizuar punën mbi bazën e planifikimit të rregullt mujor të gatishmërisë ditore për prokurorët të ndarë sipas seksioneve. Po kështu mund të themi se për pjesën dërrmuese të kohës shpërndarja e çështjeve sipas seksioneve është bërë mbi bazën e shortit elektronik, dhe vetëm në rast të mosfunksionimit të shortit elektronik shpërndarja e çështjeve është bërë mbi bazën e shortit manual të hedhur çdo ditë. Nga shorti janë përjashtuar çështjet e filluara kryesisht nga prokurorët, ato të administruara jashtë orarit zyrtar të punës ose në ditët e pushimit, si dhe ato që kërkojnë veprime urgjente nga ana e Prokurorëve, duke iu caktuar atyre që kanë filluar çështjen

kryesisht ose kanë qenë të gatshëm në ditët e administrimit të akteve, apo të cilët kanë kryer veprime urgjente me aktet hetimore. Vlen të theksohet fakti se nga ana e Drejtuesit janë nxjerrë disa urdhra për përjashtim nga shorti elektronik të prokuroreve që merrnin më shumë materiale hetimore. Shorti elektronik nuk mbante parasysh shpërndarjen në mënyrë të barabartë ditore, javore apo mujore, prandaj dhe nga ana ime është ndërhyrë me urdhra për përjashtim nga shorti me qëllim që të mos krijohet disbalancë e madhe në ngarkesat e prokurorëve.

Në zbatim të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Koordinatori për të Drejtën e Informimit i është përgjigjur me korrektësi kërkesave të ardhura në institucionin tonë, konkretisht duke trajtuar në total 10 kërkesa. Kthimi i përgjigjeve në të gjitha rastet është bërë në përmbushje të plotë të afateve kohore të përcaktuara në ligj dhe në asnjë rast e drejta për informim nuk është kufizuar.

Ka patur një koordinim dhe organizim të mirë të punës përsa i përket lidhjeve dhe informacioneve ndërmjet prokurorëve dhe zyrës së regjistrit lidhur me problematikën dhe përfshirjen e personave në kryerjen e veprave penale si dhe në mënyrën e plotësimit dhe hedhjes së të dhënave në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Gjithashtu, duhet theksuar puna e kësaj zyre në nxjerrjen e të dhënave në mbështetje të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, zyrë e cila gjatë vitit ka bërë të mundur verifikimin dhe kthimin brenda afateve të shpejta të përcaktuara në ligj të kërkesave për informacion për subjektet e rivlerësimit.

Çdo grup prokurorësh ka patur mbështetjen në infrastrukturë si dhe ndihmën e punonjësve të sekretarisë në përmbushjen e detyrave të tyre. Zyra e sekretarisë ka funksionuar rregullisht në lidhje me administrimin dhe protokollimin e materialeve të ardhura në prokurori dhe me komunikimet me institucionet dhe me subjektet e përfshira në procedimet penale.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.623 datë 26.10.2018, mbi “Miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”, punonjësit e caktuar kanë marrë masat e duhura mbi zbatimin dhe përmbushjen e saj me përpikmëri, duke i siguruar të gjithë shtetasve të drejtën për informim dhe shërbim cilësor.

Plani buxhetor për vitin 2019 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është zbatuar si më poshtë:

	Shpenzime Korrente/ në lekë	Fondi i Pagave dhe sig. shoqërore /në lekë	Shpenzim mbi Mallra, Riparime, Ekspert/ në lekë	Shpenzime për ndihmë ekon (shpëblim për dalje në pension)	Shpenzime për investim	Të ardhura nga Fotokopje Taksa Pulla. Shitje hekuri për skrap/në lekë
Plani	156.459.000	135.771.000	20.500.000	188.000	0	
Fakti	156.057.129	135.369.887	20.499.242	188.000	0	346.666
Diferenca	401.871	401.113	758	0	0	
%	99.7%	99.7%	99,99%	100%		

VIII. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN PASARDHËS DHE REKOMANDIME

Nga analizimi ne tërësi e treguesve të punës së bërë nga ana jonë për vitin 2019 jemi të vetëdijshëm se ka vend për përmirësime të treguesve konkretë, si në hetim ashtu dhe në gjykim. Sa më sipër vlerësojmë se për të ardhmen do të jenë këto prioritetet tona kryesore:

- Ndjekja me përparësi e procedimeve penale të regjistruara për shkak të tërmetit të 26 Nëntorit të vitit 2019.
- Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të procedimeve penale në fushën e krimit ekonomik sidomos ato të shkaktuara nga tërmeti i nëntorit 2019 dhe përfundimi I tyre brenda 6 mujorit, në fushën e korrupsionit, pastrimit të produkteve të veprës penale, abuzimit me detyrën nga nëpunësit shtetërorë, trafikeve të të gjitha llojeve, në fushën e veprave penale kundër jetës së personit dhe moralit, pasurisë, shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, etj.
- Rritja e përpjekjeve nga prokurorët për të bërë të mundur rritjen e treguesve të zbulueshmërisë së veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, si vrasjet, vjedhjet etj, të cilat paraqesin ndjeshmëri të lartë për komunitetin.
- Përfundimi me sukses për akuzën për fazën e gjyqimit të çështjeve që lidhen me ngjarje të rënda kriminale të viteve të mëparshme, në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet policore, për t'u dhënë mesazhin autorëve të këtyre krimeve se nuk mund t'i shpëtojnë ndëshkimit ligjor pavarësisht kohës që ka kaluar.
- Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit ndaj policisë gjyqësore, në seksionin dhe shërbimet e policisë gjyqësore në zbatim të Ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit të vendosur me strukturat drejtuese për shërbimet e policisë gjyqësore, në radhë të parë me ato të policisë së shtetit dhe strukturat e tjera ligjzbatuese, në funksion të rritjes së cilësisë së hetimit paraprak.
- Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit të punës brenda organit, me qëllim për t'u përgjigjur më mirë kërkesave për rritjen e cilësisë së punës.
- Respektimi nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore i detyrimeve të ligjit procedural penal, urdhrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Rritja e profesionalizimit të prokurorëve në hetimin paraprak, në marrjen e vendimeve përfundimtare dhe në mbrojtjen e akuzës në gjykim si dhe ruajtjen e figurës së pastër të tyre.

Në përfundim, duke vlerësuar se të dhënat e analizuara dhe problematikat e ngritura në këtë analizë pune për vitin 2019 do t'i shërbejnë si prokurorëve, ashtu edhe institucioneve të tjera përkatëse që lidhen me veprimtarinë tonë, dëshiroj të shpreh në emrin tim dhe të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës angazhimin tonë maksimal për rritjen në vijimësi të treguesve të punës së kësaj prokurorie.

DREJTUESI I PROKURORISË

ANITA JELIA

